



## MUNICIONET E TEPËRTA



**Tryezë e rumbullakët: Pocesi i demilitarizimit, progresi dhe sfidat**

*Kjo është konferenca e tretë e këtij lloji e organizuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar*

faqe 2

## BASHKËPUNIMI

**Një delegacion i lartë ushtarak i FA turke, vizitë zyrtare në vendin tonë**

faqe 2

## SIGURIA

**Ekspertët amerikanë, diskutim mbi përballimin e emergjencave detare**

*Ekspertët vizituan Komandën e FD, QNOD dhe institucione të tjera në Portin e Durrësit*

faqe 6

## EMERGJENCA CIVILE



**MM angazhohet në funksion të pastrimit të territorit**

*Në këtë nismë u përfshinë 1000 forca dhe 76 mjete, të angazhuara në akset nacionale*

faqe 4-5

## INTERVISTË PËR TELEVISIONI SHTETËROR TURK TRT

**Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli: Jemi këtu për t'i dhënë një hov të ri bashkëpunimit dypalësh**

*Gjatë intervistës u vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera shqiptaro-turke dhe u fol për bashkëpunimet në të ardhmen*



faqen 3

**Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, vizitë zyrtare në Turqi**

# Yilmaz: Shqipëria partnere e rëndësishme dhe aleat i madh

*Ministrja Kodheli, gjatë takimit me homologun turk Yilmaz, është ndalur edhe tek mbledhja e përbashkët e dy qeverive Shqipëri-Kosovë dhe shprehu bindjen se një mbledhje e tillë edhe me qeverinë turke do t'i shërbente jo vetëm dy vendeve tona, por mbarë rajonit*



faqen 2-3

## FLET ARBEN MUÇA, UDHËHEQËSI ARTISTIK I OFFA

**OFFA, kryefjala e pritjeve ceremoniale dhe jetës artistike**



*Formacioni i parë zyrtar i Bandës Shqiptare u krijua gjatë viteve 1912-1915. Gjatë viteve 1928-1939, u formua formacioni i parë profesionist-artistik i quajtur Banda e Gardës Kombëtare dhe më pas Banda Mbretërore. Orkestra Frymore e Ushtrisë u krijua në tetor të vitit 1944 në fshatin Priskë pranë kryeqytetit (Tiranë) dhe kishte si personel artistik rreth 25 instrumentistë, muzikantë partizanë si dhe ish-pjesëtarë të bandave të krijuara gjatë viteve 1928-1939.*

faqe 8-9

## STËRVITJA VIRTUALE

**"Qendra e Simulimit", vizion i qartë dhe konsolidim i dukshëm**

faqe 7

## SIGURIA

**Ndërveprimi, thelbi i suksesit të FA për sigurinë kolektive**

faqe 11

## VISIONI I PRESIDENTIT

**Obama flet për arsimin, ekonominë, politikat sociale dhe FA**

faqe 12

## FORCA AJRORE



**Në Bazën Ajrore Farkë, atje ku jeta gjallon mes tokës dhe ajrit**

*Viti 2014 si objektiv kryesor të punës së personelit të kësaj Baze ka rritjen e shkallës së gatishmërisë operacionale për realizimin e misionit*

faqe 11



Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, vizitë zyrtare në Turqi

# Yilmaz: Shqipëria partnere e rëndësishme dhe aleat i madh

**M**inistrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, zhvilloi këtë javë një vizitë zyrtare dyditore në Ankara, Turqi, me ftesë të homologut të saj, ministrit të Mbrojtjes së Turqisë, Ismet Yilmaz. Në takimin që ministrja Kodheli zhvilloi me ministrin e Mbrojtjes së Turqisë, Ismet Yilmaz u nënvizua niveli shumë i mirë i marrëdhënieve mes dy vendeve tona, si dhe u diskutua për gjetjen e potencialeve për t'i çuar ato më tej. Ministri turk i Mbrojtjes tha se, Turqia e shikon Shqipërinë si një partnere të rëndësishme dhe aleat të madh të saj. Në këtë kontekst, në emër të qeverisë turke z. Yilmaz siguroi ministrin Kodheli për mbështetjen e padiskutueshme të Turqisë për Shqipërinë për marrjen e statusit të vendit kandidat për BE. Më tej, dy zyrtarët e lartë, duke u ndalur tek marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes, vlerësuan bashkëpunimin shumë të mirë mes dy vendeve tona. Në këtë kuadër, në Turqi janë arsimuar dhe kualifikuar 2500 studentë ushtarakë shqiptarë që nga viti 1992 e në vazhdim, ndërsa aktualisht në këtë vend studiojnë 86 të tillë. Gjithashtu, gjatë këtij takimi dy homologët diskutuan edhe për projekte konkrete bashkëpunimi, duke parë mundësinë e investimeve turke në Aeroportin e Kuçovës apo në Bazën e Pashalimanit. Ministrja Kodheli e njohu homologun



e saj edhe me rolin e Shqipërisë në çështjet rajonale. Ajo është ndalur edhe tek mbledhja e përbashkët e dy qeverive Shqipëri-Kosovë dhe shprehu bindjen se një mbledhje e tillë edhe me qeverinë turke do t'i shërbente jo vetëm dy vendeve tona, por mbarë rajonit. Në vijim të kësaj vizite, znj. Kodheli u prit

në një takim tejet të ngrohtë edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral armate Necdet Ozel. Gjenerali Ozel ka nënvizuar fort vullnetin e FA të Turqisë për të mbështetur FA të Shqipërisë në të gjitha nevojat e tyre. Në këto takime, znj. Kodheli kërkoi të gjenden mundësi bashkëpunimi, sidomos në fushën e

industrisë ushtarake, duke theksuar se Shqipëria duhet të mbajë patjetër në funksion Uzinat e Poliçanit, Mjekësit apo të Gramshit, si të vetmen mundësi ekonomike për banorët e këtyre zonave. Më herët, ministrja e Mbrojtjes Kodheli vendosi një kurorë me lule në Mauzoleumin e Mustafa Qemal Atatürkut.

## Delegacioni i lartë ushtarak i FA të Republikës së Turqisë, vizitë zyrtare në vendin tonë

**N**jë delegacioni i lartë ushtarak i Republikës së Turqisë, i kryesuar nga gjenerallejtnant Mehmet Daysal, drejtor i Drejtorisë së Inteligjencës, zhvilloi në datë 12 shkurt 2014 një vizitë zyrtare në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në kuadër të marrëveshjes bilaterale Shqipëri-Turqi dhe planit vjetor të aktiviteteve. Delegacioni u prit me truprojë nderi nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Viktor Berdo. Të pranishëm në ceremoni ishin drejtorë drejtorish në MM dhe SHP. Një pritje e veçantë delegacionit ushtarak turk iu rezervua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjeneral Bazo pasi shprehu kënaqësinë për vizitën dhe e falënderoi për mbështetjen që Turqia i ka dhënë Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura shqiptare, vlerësoi nivelin e lartë të marrëdhënieve të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve, dy ministrive dhe Shtabit të Përgjithshëm, si dhe shprehu bindjen, dëshirën dhe vullnetin për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi. Gjenerallejtnant Daysal, falënderoi gjeneral Bazon për pritjen e ngrohtë dhe mjaft miqësore që iu rezervua delegacionit të cilin ai kryeson, vlerësoi arritjet e deritanishme të FA shqiptare, si dhe shprehu bindjen se marrëdhëniet e shkëlqyera që ekzistojnë midis dy vendeve tona do të shënojnë progres edhe në të ardhmen. Më pas, delegacioni i lartë ushtarak turk, ka vijuar axhendën e tij me një vizitë në Batalionin Special, të Forcës Tokësore, ku është pritur nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Zyber Dushku.

## Konferenca e tretë me ndërkombëtarët për procesin e demilitarizimit

# Demilitarizimi, progresi dhe sfidat

**N**ë Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës të Elbasanit është zhvilluar në datën 7 shkurt 2014, tryeza e rumbullakët me temë: Procesi i demilitarizimit, progresi dhe sfidat. Në këtë veprimtari ishin të pranishëm: ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Ndodheshin gjithashtu ambasadori i SHBA në Tiranë, Alexander Arvizu, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Nikolas Cannon, kryetari i Zyrës së Prezencës së OSBE në Tiranë, ambasadori Florian Raunig, përfaqësues nga UNDP, si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Duke marrë fjalën në këtë aktivitet ministrja e Mbrojtjes Kodheli ka theksuar:

Kjo është konferenca e tretë e këtij lloji e organizuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar. Sot, vëmendja jonë është mbi një çështje mjaft të ndjeshme për Forcat e Armatosura Shqiptare dhe për publikun shqiptar, demilitarizimi i municioneve të tepërta dhe eliminimi i kimikateve të rrezikshme. Siç jeni në dijeni, ndryshe nga konferencat e mëparshme, ne vendosëm të organizojmë këtë aktivitet këtu në Mjekës, një prej tre uzinave të demilitarizimit të Ministrisë së Mbrojtjes. Ky vend ka një domethënie të veçantë, sidomos për objektin e kësaj konference. Pas diskutimeve tona, ju ftojme të gjithëve për të vizituar uzinën. Zëvendësministri do të japë shkurtimisht një briefing të detajuar mbi këtë temë, i cili shpesh do të sjellë diskutime dhe shkëmbime pikëpamjesh.

Unë e di se shumë prej jush kanë dijeni për çështjen e demilitarizimit në Shqipëri dhe kanë ndjekur dhe dëshmuar nga afër përparimin e rëndësishëm që është arritur gjatë viteve të fundit. Pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria trashëgoi një rezervë (stok) mjaft të madh të municioneve të tepërta, armatime, pajisje ushtarake dhe infrastrukturë. Pjesërisht, ajo përfshinte gati 200.000 ton municione të ruajtura në 45 vende magazinimi në të gjithë vendin dhe 316.000 armë të kalibrit të vogël dhe armë të lehta. Kjo rezervë (stok) tepër e madhe përbente një rrezik të madh për mbrojtjen dhe sigurinë e popullatës. Teksa Forcat e Armatosura Shqiptare rristrukturoheshin dhe zvogëloheshin në numër gjatë dekadës së fundit, barra e vazhdueshme e kujdesjes për këto materiale u bë e papërbalueshme. Për këtë arsye, Shqipëria zhvilloi një program agresiv për të korrigjuar plotësisht gjendjen e trashëguar nga e kaluara, për të liru vendin nga kjo trashëgimi e rëndë dhe për të krijuar një ambient të sigurt për qytetarët tanë. Programi ynë i demilitarizimit, që vijon ende, është gjithashtu një kontribut i rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Nuk kemi dashur dhe nuk duam që ky material të bjerë në duar të gabuara! Ministria e Mbrojtjes ia ka dalë me sukses të demilitarizojë thuhet 80% të



municioneve të tepërta gjatë pesë viteve të fundit; një përpjekje që nuk do të kishte qenë e mundur pa asistencën e donatorëve tanë ndërkombëtarë. Prandaj, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të qeverisë shqiptare, unë shpreh mirënjohjen tonë të thellë për qeveritë e Shteteve të Bashkuara, Republikës Çeke, Danimarkës, Finlandës, Gjermanisë, Greqisë, Italisë, Holandës, Suedisë dhe Turqisë për mbështetjen e tyre. Përveç kësaj, falënderoj Prezencën e OSBE në Shqipëri për mbështetjen e tyre dhe rolin koordinues, agjencinë e NATO për Mbështetje, Fondin Ndërkombëtar të Besimit, UNDP (Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara), Zyrën

për Reduktimin e Armëve dhe Agjencinë amerikane për Reduktimin e Rreziqeve të Mbrojtjes, të gjithë ata të cilët kanë qenë gjithashtu të dobishëm në suksesin e vazhdueshëm të këtij procesi. Ne gjithmonë do t'ju jemi mirënjohës, të gjithë juve, për asistencën tuaj. Gjithashtu, përfitoj nga rasti të shpreh mirënjohjen time të thellë për angazhimin dhe punën e përkushtuar për demilitarizimin bërë nga administrata e mëparshme, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe punëtorët e tre uzinave ushtarake. Përveç kësaj, shpreh falënderime për pushtetin vendor për mbështetjen e tyre ndaj këtij procesi kombëtar. Shqipëria trashëgoi një detyrë masive nga regjimi

i shkuar. Demilitarizimi dhe eliminimi i armatimeve dhe municioneve të tepërta, i një sasi të konsiderueshme kimikatesh të rrezikshme, si edhe qindra mijëra objekte shtesë që shërbenin si pajisje të Forcave të Armatosura, vazhdon të mbetet prioritet për Ministrinë e Mbrojtjes. Bashkëpunimi reciprok në këto përpjekje është një histori suksesi. Gjithashtu është e rëndësishme të vazhdojë deri në fund ky bashkëpunim. Për këtë qëllim, unë jam këtu t'u kërkoj mbështetje për përfundimin e këtij procesi në mënyrë të sigurt dhe të parrezikshme për vendin dhe qytetarët tanë. I jam shumë mirënjohës qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe qeverisë gjermane, që janë angazhuar si donatorë për vazhdueshmërinë e procesit të demilitarizimit. Gjatë këtij takimi ka folur edhe ambasadori i SHBA në Tiranë, Alexander Arvizu, kryetari i Zyrës së Prezencës së OSBE në Tiranë, ambasadori Florian Raunig, si dhe përfaqësuesi i UNDP. Më tej, nga pjesëmarrës në këtë veprimtari janë bërë pyetje, diskutime dhe shkëmbime mendimesh për mjaft çështje që lidhen me procesin e demilitarizimit të municioneve, arritjet e shënuara deri tani, problemet dhe sfidat që dalin në të ardhmen për përmbylljen me sukses të plotë të këtij procesi të rëndësishëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura. Në fund, ministrja e Mbrojtjes Kodheli e shoqëruar nga ambasadorët dhe pjesëmarrës të tjerë në këtë aktivitet, inspektuan nga afër mjediset dhe disa nga repartet e demontimit të municioneve të Uzinës së Lëndëve Plasëse në Mjekës.

Burimi: mod.gov.al



Intervista e plotë e ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, dhënë televizionit shtetëror turk, TRT

# Ministrja Kodheli: Jemi këtu për t'i dhënë një hov të ri bashkëpunimit dypalësh

**D**uke i uruar mirëseardhjen, znj. Kodheli, le të flasim për marrëdhëniet midis dy vendeve tona dhe ndihmën që do të japë Turqia për integrimin në BE. Që nga shtatori i vitit të kaluar, ju jeni ministre e Mbrojtjes. Pyetja kryesore ka të bëjë me politikën e sigurisë kombëtare. Si e përkufizoni ju këtë?

Patjetër që kjo temë është e rëndësishme sepse ne ndodhemi në një rajon ku problemet janë të shumta dhe roli i Shqipërisë është i rëndësishëm dhe gjithmonë ka qenë i tillë. Ne si Shqipëri dhe si shqiptarë, jemi duke bërë përpjekjet maksimale për sigurinë e tij. Si vend anëtarë i NATO-s për ne kjo ka një rëndësi të veçantë. Siç e dini, ne marrim pjesë me trupat tona në misionin ISAF në Afganistan, gjithashtu përveç kësaj ne marrim pjesë edhe në misione të tjera të përbashkëta në kuadër të NATO-s dhe BE-së, për të mbështetur paqen dhe zhvillimin e demokracisë në këto vende. Kur flasim për sigurinë kombëtare, këtu kam parasysh jo vetëm sigurinë e shqiptarëve, por edhe të atyre vendeve ku ne marrim pjesë dhe kontribuojmë. Të gjithë ne kemi nevojë për këtë siguri.

**Ju jeni takuar me ministrin e Mbrojtjes të Turqisë dhe aty u theksua se Shqipëria është faktor i rëndësishëm në rajon nga pikëpamja e sigurisë. Gjithashtu u nënvizua niveli i lartë i marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Ju, çfarë do të shtoni në lidhje me rritjen dhe fuqizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis vendeve tona?**

Këto marrëdhënie nuk janë të rëndësishme vetëm në fushën strategjike dhe ekonomike, por edhe në atë të mbrojtjes. Ne jemi vend anëtarë i NATO-s dhe prej disa vitesh, në mënyrë reciproke, shumë veprimtari tonat i kemi koordinuar së bashku. Si vend anëtarë i NATO-s ne jemi pjesë e ndryshimeve që po ndodhin në NATO dhe jemi duke i vlerësuar ato. Duke pasur parasysh vështirësitë ekonomike me të cilat po përballet sot bota, jemi duke komunikuar në mënyrë të ndërsjellët për gjetjen e zgjidhjeve, sa më të mira dhe duke pasur parasysh këtë jemi duke vlerësuar "Smart Defense". Për këtë ne jemi të detyruar të bashkëpunojmë dhe bashkëveprojmë, si dhe të hedhim hapa të sigurt dhe të përbashkët. Të gjitha këto ne jemi duke i diskutuar sa herë ne takohemi në kuadër të NATO-s. Dhe sikurse e theksova, të gjitha këto mund të jenë të zgjidhshme me bashkëpunim. Këtë bashkëpunim e quajmë të rëndësishëm edhe kur biseduam me homologun tim jo vetëm në fushën ekonomike. Gjithashtu kemi folur për bashkëpunim në fushën e industrisë ushtarake. Kjo, në varësi



Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, gjatë intervistës në televizionin TRT Turk



të mundësive tona. Këto pikëpamje ne i hodhëm edhe në diskutimin që patëm. Gjithashtu me ministrin e Mbrojtjes ne diskutuan për fushat e bashkëpunimit, ku Shqipëria ka nevojë më shumë, sidomos në ndihmën për pajisje me mjete ushtarake. Gjithashtu bëhet fjalë për një ndihmë rreth tre milionë euro dhe kjo mbështetje është duke vazhduar e për këtë arsye, falënderoj ministrin dhe Kryeministrin e Turqisë. Plus kësaj nga marrëveshja e firmosur ndërmjet MM dhe spitalit Gata të Turqisë, ne u takuam me drejtorin e përgjithshëm të spitalit Gata. Në kuadër të bashkëpunimit ne do të mund të dërgojmë personelin, i cili nuk mund të trajtohet në spitalet tona. Dua të shpreh kënaqësinë time për këtë bashkëpunim. Gjithashtu u diskutua për rritjen e numrit të personelit që do të mund të trajtohen në spitalin e GATA-s.

**A mund të thelloheni më shumë në lidhje me marrëdhëniet e Shqipërisë, Turqisë dhe NATO-s?**

Kjo është e rëndësishme nga pikëpamja e demokracisë, sigurisë, si dhe për sa i përket vendeve anëtare të NATO-s, sepse kjo përfaqëson një Aleancë të fuqishme. Tani të gjitha këto vende kontribuojnë për NATO-n, pra dhe marrëdhëniet janë në këtë kontekst është mjaft e rëndësishme. Nga pikëpamja gjeopolitike, trajtimi së bashku i të gjitha problemeve kërkon një bashkëpunim të rëndësishëm. Në kuadër të kësaj platforme Shqipëria dhe Turqia, ministrin respektive

janë duke bashkëpunuar në fushën e inteligjencës, por edhe në fusha të tjera si dhe në atë të mbrojtjes. Gjithashtu rëndësia gjeopolitike është domethënëse. Sikurse e theksova, këtu u fol edhe për bashkëpunimin tonë me Kosovën, kjo brenda kornizës ligjore. Qëllimet tona të përbashkëta në njëfarë mënyre ne mund t'i gjejmë nga pikëpamja ekonomike apo edhe në fusha të tjera të bashkëpunimit të Shqipërisë me vendet e tjera për ta bërë këtë më efektive. Natyrisht që nëse ju dini të përdorni fushat e bashkëpunimit në një botë të re, në lidhje me këtë, hidhni edhe hapat e rëndësishëm e të duhur për realizimin e paqes - dhe këtë jemi të detyruar ta bëjmë. Në këtë pikëpamje si qeveri e re jemi duke u përpjekur për të hedhur hapat e duhur.

**Po në lidhje me rolin e ushtrisë çfarë mendoni?**

Ka qenë dhe mbetet i rëndësishëm roli i ushtrive.

**Lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit të vitit 1992 deri në vitin 2005 kemi vërejtur se janë hedhur hapa të rëndësishëm dhe, cilat mendoni ju që janë arsyet e kësaj?**

Natyrisht që gjatë kësaj periudhe gjërat dhe qeveritë kanë ndryshuar dhe ne prandaj jemi këtu për t'i dhënë një hov të ri këtij bashkëpunimi. Për shqiptarët, është i rëndësishëm angazhimi i tyre në punë si dhe që të jetojnë në një ambient të sigurt. Gjithashtu për ne politikanët është e rëndësishme që të japim sa më shumë të jetë e mundur, një vizion për realizimin e këtyre detyrimeve

ndaj njerëzve tanë. Për këtë jemi duke vlerësuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi dhe për këtë arsye duhet të bashkëpunojmë e të hedhim hapa të përbashkëta. Është i rëndësishëm bashkëpunimi jonë dhe marrëdhëniet Shqipëri-Turqi pikërisht këtë po nxjerrin në pah. Sikurse është e rëndësishme marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë, po kështu janë të rëndësishme edhe marrëdhëniet me shtetet e tjera. Për ne është e rëndësishme të mendojmë për bashkëkombësit tanë. Arsyet pse ne jemi këtu dhe pse po zhvillojmë këto bisedime, përbën një moment tjetër, që ne të hedhim hapat e duhur në drejtimin e duhur. Sepse kur mendojmë, koha rrjedh shumë më shpejt nga ç'e mendojmë ne dhe për këtë duhet të jemi një hap para kohës.

**Përveç marrëdhënieve në fushën ushtarake dhe politike, në cilat fusha mendoni ju që mund të intensifikohen më tej këto marrëdhënie?**

Bëhet fjalë për fusha dhe drejtime të ndryshme. Në bisedën që pata me ministrin e Mbrojtjes, z. Yilmaz diskutuam për projektet ushtarake që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe zhvillimin e tyre. Ky proces mund të zhvillohet dhe zgjerohet sidomos në drejtim të industrisë ushtarake. Për këtë nevojitet një vizion i ri. Këtu kam parasysh ato projekte për të cilat rezervohen burime. Këto, në një këndvështrim të ri, mund t'i rinovojmë e për këtë është e nevojshme ndërhyrja e përbashkët dhe duhet të bëhen investime në fushën ushtarake. Duhet të rritet shkalla e ndihmës dhe të përmirësohen kushtet e punës dhe mendoj, se në këtë kontekst, mund të hapen shumë vende pune. Këtu kam parasysh mundësitë e sigurisë në punë, kushte të mira të punës - dhe mendoj se këto do të sjellin rezultate më të mira. Të gjitha këto i diskutuam në takimin që kishim.

**Cila është pritshmëria nga investitorët tanë dhe të huaj në**

**fushën e sigurisë?**

Në Shqipëri bëhet fjalë për një situatë që tërheq investimet. Duhet që të thihen sa më shumë investime të huaja. Kemi më shumë nevojë për investime në Shqipëri. Me të vërtetë që në Shqipëri ka mundësi për këto investime. Këtë e them, mbështetur në kushtet e favorshme që ekzistojnë për investimet në Shqipëri. Në një vend të sigurt mund të tërhiqen investime të shumta. Të gjitha kushtet juridike janë të krijuara tashmë dhe kështu që investitorët mund të investojnë në Shqipëri. Këtë dua ta nënvizoj, që përveç mundësive që ofron vendi ynë, edhe veprimet për t'u legalizuar si investitor janë më të thjeshta dhe krahu i punës është më i lirë. Në tregun e punës ata janë më të arsimuarit, dhe në Shqipëri mund të gjendet një krah punë më i kualifikuar. Mundësitë e prodhimit në uzinat tona ushtarake janë në kosto të ulët dhe kjo ndikon pozitivisht në ekonominë tonë. Për këtë jemi duke zhvilluar marrëveshje për projekte të cilat duhet t'i bëjmë realitet dhe si rezultat i tyre të arrijmë suksesin.

**Të kalojmë në temën e BE. Në këtë kontekst vazhdon një proces? Ç' mendim keni lidhur me BE?**

Mendoj se jemi në rrugë të drejtë dhe e ardhmja e Shqipërisë është BE-ja. E humbëm një shans dhjetorin e kaluar, por mendoj se jemi në rrugë të drejtë. Shqipëria dhe politika shqiptare këtë e meriton. Por mbi këtë, mendoj se populli shqiptar e meriton statusin, pavarësisht mendimeve të disa prej politikanëve evropianë. Tek kjo jemi përqendruar të gjithë. Në lidhje me temën e luftës kundër korrupsionit, jemi të fokusuar dhe për këtë, atë që ne duhet ta bënim, jemi duke e bërë. Kjo është një rrugë e rëndësishme dhe ne nuk jemi vetëm. Siç dihet është një proces ku ne kemi përkrahjen e miqve tanë të rëndësishëm ndërkombëtare dhe në qoftë se do të flisnim për miqtë tanë në arenën ndërkombëtare, duke e parë këtë në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, duhet të theksoj se gjatë gjithë kohës vërehen ndryshime; qeveritë ndryshojnë dhe në këtë kontekst mirësia do të peshojë më shumë. Ne jemi optimistë dhe shpresoj që në një kohë të shkurtër të ndodhin ndryshime të rëndësishme. Dua të falënderoj qeverinë turke për mbështetjen, veçanërisht për ndihmën e madhe që i ka dhënë Kosovës. Në këtë kuadër edhe miqtë tanë ndërkombëtarë po na mbështesin në rrugën tonë drejt marrjes së statusit të vendit kandidat në BE. Duke ju falënderuar për intervistën që më mundësuar në televizionin tuaj, gjej rastin të përsërisht qytetarët e vendit tim, pasi e di që ju transmetoni në gjuhën shqipe. Faleminderit!



Forcat e Armatosura të RSH kontribuojnë me forca dhe mjete në pastrimin e territorit

# MM angazhon 1000 forca dhe 76 mjete në funksion të pastrimit të territorit

Shtabi i Përgjithshëm me gjithë strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të shpalljes së emergjencës civile për gjendjen e mjedisit nga komisioni ndërrministrior, angazhon 1000 forca dhe 76 mjete në funksion të pastrimit të territorit. Në orët e para të mëngjesit të sotëm efektive të Forcave të Armatosura të RSH janë angazhuar në akset nacionale, kryesisht në zonën Lezhë-Shkodër, duke pastruar mbetjet. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila ndoqën nga afër të gjithë procesin e pastrimit dhe ftuan komunitetin t'i bashkohen kësaj nisme. Gjeneralmajor Bazo u shpreh se bashkëpunimi civilo-ushtarak është një element mjaft i rëndësishëm që i vjen në ndihmë komunitetit dhe të gjithë shoqërisë shqiptare, e cila vuan shumë nga problemi me mbetjet urbane. "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër", është motoja e kësaj nisme, ndaj dhe të angazhohemi maksimalisht në funksion të këtij qëllimi, nënvizoi gjeneralmajor Jeronim Bazo. Akset kryesore në të cilat ushtria bëri pastrimin e territorit sot ishin: Hani i Hotit - Shkodër; Muriqan - Shkodër; Ura e Bunës - Shirokë; Shkodër - Lezhë - Milot, duke bërë të mundur pastrimin e 76km rrugë dhe transportimin me mjetet e Forcave të Armatosura të mbetjeve të nxjerra për në vend-grumbullimin e tyre.

## FORCA TOKËSORE

**550 trupa të Forcave Tokësore, angazhohen në heqjen e mbetjeve në aksin Lezhë-Shkodër**

"Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër", kjo ka qenë nisma e Forcave të Armatosura për të pastruar territorin e Republikës së Shqipërisë. Forca Tokësore, si pjesë përbërëse e FA, më datë 8 shkurt 2014 u angazhua me strukturat e saj, në pastrimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në një territor të kontaminuar në aksin rrugor Lezhë-Kryqëzimi Ishull Lezhë, Kthesa e Zejmenit-Kryqëzimi i Tales, Hani i Hotit-Koplik, Koplik-Omaraj dhe Muriqan-Shkodër. Në qarqet Lezhë dhe Shkodër, Forca Tokësore angazhoi rreth 550 trupa dhe 35 mjete. Gjatë operacionit në ndihmë të komunitetit janë pastruar rreth 67.4 km rrugë dhe janë hequr rreth 40 ton mbeturina. Trupat e angazhuara në këtë aktivitet u inspekuan nga afër nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku. Në takimin që shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, pati me efektivet e Forcës Tokësore, falenderoi trupat për punën e bërë dhe përfaqësuesit e pushtetit vendor për bashkëpunimin dhe njëkohësisht përcolli mesazhin, "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër". Ai u shpreh se kjo nismë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, e cila do të përfshijë edhe akse të tjera rrugore, si dhe portet dhe aeroportet. Në përfundim



të këtij procesi, efektivet morën falenderime të veçanta edhe nga përfaqësuesit e pushtetit vendor në zonat ku ata ishin të angazhuar.

"Procesi ishte aq i mirëkoordinuar, ku nuk mund të dalloje zonat e pastrimit ndërmjet forcave apo reparteve të ndryshme, pasi gjithçka ishte në sinkronë të plotë. Impakti tjetër pozitiv që pati kjo veprimtari ishte mbështetja masive e qytetarëve, veçanërisht në qytetin e Lezhës, të cilët jo vetëm që e përkrahën këtë iniciativë por ishin gati të bëheshin pjesë e saj. Ndiha ishte e dy anshme, pasi forcat tona ushtarake dhe qytetarët njëkohësisht me këto lloje veprimtarish, njohin dhe e prekin së bashku realitetin, si dhe konkretizojnë vënien në shërbim të njëra tjetrës. Kuptohet se, kalimi nga një gjendje e ndotur në një ambient të pastër nuk do të jetë e lehtë, por jo e pamundur. Pas arritjes së këtij objektivit, mbetet detyrim mbarëqytetar për të mbrojtur ambientin dhe mbajtur atë të pastër. Kjo veprimtari është vijuese dhe mbi bazën e urdhrave, udhëzimeve dhe planeve përkatëse të Ministres së Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm i FA, ne do të vazhdojmë të japim kontributin tonë në gjithë hapësirat e planifikuara për ti kthyer në normalitet. Pa dyshim që po nxjerrim mësim edhe për ndonjë mangësi që konstatuam në ditën e parë të punës. Mbi këtë bazë do të japim maksimumin tonë për një Shqipëri të pastër, duke gjetur mirëkuptimin e qytetarëve për një bashkëpunim maksimal jo vetëm në fazën e pastrimit, por edhe në mbajtjen e ambientit të pastër edhe pas përfundimit të këtij operacioni kombëtar. Jemi optimist për të arritur objektivat pasi deri tani kemi patur një mbështetje të admirueshme dhe mirëkuptim të plotë nga të gjitha organet e pushtetit vendor. Rezultatet e arritura, u vunë re që në ditën e parë të punës, ku Forcat Tokësore morën pjesë në hapësirën Hani i Hotit, Shkodër, Muriqan, Lezhë, Milot. Vlen të përmendim masat koordinuese të marra, si brenda strukturave të FA-së ashtu edhe me strukturat e pushtetit vendor. Procesi ishte aq i mirëkoordinuar, ku nuk mund të dalloje zonat e pastrimit ndërmjet forcave apo reparteve të ndryshme, pasi gjithçka ishte në sinkronë të plotë. Impakti tjetër pozitiv që

pati kjo veprimtari ishte mbështetja masive e qytetarëve, veçanërisht në qytetin e Lezhës, të cilët jo vetëm që e përkrahën këtë iniciativë por ishin gati të bëheshin pjesë e saj" - thotë kolonel Dilaver Hoxha, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore.

N. B.

## FORCA AJRORE

**Forca Ajrore angazhohet dhe merr pjesë në pastrimin e territorit në funksion të nismës "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër"**

Më datën 08 shkurt 2014 pas detyrës së marrë nga Shtabi i Përgjithshëm i FA, efektivet e Forcës Ajrore qysh herët në mëngjes u angazhuan për pastrimin e mbetjeve në zonën Bushat-Beltoje në Shkodër në funksion të nismës "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër". Trupat e angazhuar në këtë aktivitet u inspekuan nga afër nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjeneralbrigade Frederik Beltoja ndoqi nga afër të gjithë procesin e pastrimit. Më herët u krye edhe bashkëpunimi civilo-ushtarak si një element mjaft i rëndësishëm që i vjen në ndihmë komunitetit. Në takimin që shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, pati me efektivet e Forcës Ajrore, falenderoi trupat për punën e bërë dhe njëkohësisht përcolli mesazhin, "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër". Ai u shpreh se kjo nismë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, e cila do të përfshijë edhe akse të tjera rrugore, si dhe portet dhe aeroportet. Gjatë ditës së pastrimit, nga Forca Ajrore morën pjesë 60 forca, 5 mjete dhe u pastruan 7.8 km rrugë dhe mbetjet e nxjerra u transportuan me mjetet e Forcës Ajrore për në vend-grumbullimet e tyre.

F. A.

## FORCA DETARE

**Forca Detare në aksion për pastrimin e mjedisit**

Paraditen e datës 8 shkurt, në zbatim të urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA për pastrimin e akteve rrugore kombëtare nga mbeturinat e ndryshme, mbi 50 quadro oficerë, nënoficerë dhe ushtarë profesionistë të Forcës Detare

sesshëm në këtë operacion civilo-ushtarak që do vazhdojë dhe javët e ardhshme në akse të tjera kombëtare.

Sh.K.

## BrMR

**Punë intensive për pastrimin dhe sistemimin e mbeturinave inerte**

Në datën 8 Shkurt 2014, në zbatim të urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, "Për pjesëmarrje në aktivitetin që zhvillohet për nismën "Shqipëria është e të gjithëve ta mbajmë atë të pastër" në qarkun Shkodër, Brigada e Mbështetjes Rajonale u angazhua dhe dha kontributin e saj për pastrimin në aksin rrugor Shkodër Koplik dhe Komuna Ana e Malit. Në këtë operacion punuan 35 efektive dhe 6 mjete të batalionit të kërkim shpëtimit. Batalioni i xhenios u angazhua për pastrimin e Bashkisë Lezhë, Aksit Hani i Hotit-Koplik, Aksi Koplik Omaraj, Aksi Milot - Kryqëzimi i Ishullit Lezhë me 52 efektive dhe 10 mjete. Komanda e Brigadës së Mbështetjes Rajonale dhe Komandantët e reparteve morën masa të plota për sigurimin e mjeteve të punës, dhe të personelit efikas për të patur një angazhim sa më me rendiment. Puna u përqendrua në pastrimin dhe sistemimin e mbeturinave inerte dhe transportimin e tyre në pikat e grumbullimit. Në përfundim të punës për pastrimin në Komunën Ana e Malit Ura e Bunës -Muriqan u hoqën 108 m3 mbetje inerte dhe plehra. Mbetjet u transportuan nga 6 mjete të cilat kryen 9 rrugë në distancën 6 km. Në Aksin Shkodër Koplik pastruan 8 tonë mbetjet urbane në gjatësinë 5 km nga dy krahët e rrugës. Në Bashkinë Lezhë (Lagja Skëndërbej) u angazhuan 3 mjete V-Sh Fadromë në grumbullimin, ngarkimin, transportin mbeturina inerte rreth 165 m3 në distancë 6 km. Në Aksin Hani i Hotit -Koplik, u angazhuan 20 Mjete V-SH, 1 Fadromë në pastrimin dhe evadimin e materialeve inerte dhe dherash 35 m3 dhe heqje mbeturinash urbane 6 m3. Në Aksin Koplik - Omaraj u angazhuan në grumbullim ngarkim transport mbeturinash urbane në landfillin e Bushatit në distancë 1 km 7 m3 inerte. Në Aksin Milot-Kryqëzimi Ishull Lezhë







u angazhuan 3 mjete në grumbullim, ngarkim transport mbeturina urbane 25 m3. Forcat e angazhuara në pastrimin e akteve u inspektuan nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, dhe komandanti i Brigadës së Mbështetjes Rajonale gjeneralbrigade Muhamet Buçpapa.

**RMSHPFA**

**RMSHPFA në komentën e Tv "Rozafës" dhe Tv "Koplikut"**

Banorët e Koplikut, ende nuk ishin zgjuar mirë, kur në fundjavën e kaluar si rrallëherë kishin miq me uniformë, këta të fundit të angazhuar në aksionin në kuadër të Emergjencës Civile për gjendjen e mjedisit. Regjimenti i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, angazhoi në këtë operacion një personel prej shtatëdhjetë veta. E gjithë puna u përqendrua përgjatë aksit rrugor Koplik-Omaraj, një distancë prej dhjetë kilometër. Kryetar i Bashkisë së Koplikut Ramadan Lika, duke falënderuar në lidhje me këtë nismë, ndër të tjera do të veçonte "Angazhimi i Forcave të Armatosura në këtë aksion, shërben dhe si nxitje për qytetarët e Koplikut, për të mbajtur të pastër qytetin, mbasi ai është pjesë e aksit që lidh Shqipërinë me Malin e Zi". Nënkolonel Dedë Marku zëvendëskomandant i Regjimentit të Mbështetjes, i vendosur në krye të këtij operacioni, natyrshëm këmbënguli në bashkëpunimin me kryebashkiakun e Koplikut, kryetarin e Komunës Qendër Isa Rama, si dhe kryeplakun e fshatit Polvar Enver Kurti. Ky bashkëpunim, më shumë vlejti për të përcaktuar zonat ku do të përqendrohej puna, në mënyrë të tillë që rezultati të ishte pozitiv dhe i dukshëm. Sipas kryetarit të Komunës Qendër Isa Rama "Pothuaj vazhdimisht, mediat e përqendrojnë vëmendjen e tyre në ambientin e ndotur përqark Urës së Banushit, ndaj puna e kryer këtu nga ana e ushtarakëve, është një shembull, që jo vetëm ne si drejtues vendor e vlerësojmë, por në këtë frymë është dhe komuniteti këtu në zonë. Ishte fakt që kryesisht puna të përqendrohej pikërisht aty përqark Urës së Banushit, nga ku u bë e mundur largimi i inerteve dhe mbetjeve të tjera të përziera, gjë të cilën e komentuan shumë pozitivisht dhe mediat lokale e reporterët e medias kombëtare. Pjesëmarrësve të strukturës së Regjimentit të Mbështetjes në këtë aksion iu bashkuan dhe një pjesë e punonjësve të Bashkisë së Koplikut. A.Z.

**BRIGADA LOGJISTIKE**

**Pastrohen 10 kilometra rrugë dhe transportohen 25 ton mbeturina nga BrL**

Pastrohen 10 kilometra të rrugës nacionale Tiranë Shkodër dhe transportohen për në lamfillde mbi 25 ton plehra të paketuara në thasë. Brigada Logjistike në kuadër të aksionit për një Shqipëri të Pastër të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes ishte pjesë e rëndësishme e forcave të Armatosura që për një ditë pastruan tërë mbeturinat që ishin në dy anët e rrugës nacionale Lezhë Shkodër. Kolona e Brigadës Logjistike e përbërë nga 80 forca dhe pesë automjete udhëtojnë drejt Beltojës së Shkodrës që në orën 5.00 të datës 8 shkurt 2014. Në orën 7.00 forcat e Brigadës Logjistike të drejtuara nga komandanti i Brigadës gjeneral Syrja Gjoka u rreshtuan në Beltojë dhe ngritën çadrën për shtabin e këtij aksioni nën siglën për Një Shqipëri të pastër. Gjysmat e forcave u ndanë në segmentin nga Beltoja deri në Shkodër dhe gjysma tjetër nga Beltoja deri në Bushat duke grumbulluar në thasë plasmasi të gjitha mbeturinat që ishin në dy anët e rrugës. Kompania e shtabit e drejtuar nga komandanti i saj filloi pastrimin në segmentin prej pesë kilometrash nga Beltoja deri në Shkodër dhe ishte në zonën më të vështirë të aksionit të gjithë trupave pjesëmarrëse. Nënkolonel Maks Oranlliu shefi i operacioneve në Brigadën Logjistike ishte në krye të këtyre trupave dhe gjatë gjithë kohës nën drejtimin e zëvendëskomandantit të Brigadës Logjistike kolonel Besnik Sylaj jo vetëm që inspektonin segmentin prej 10 kilometrash por dhe ndihmon trupat që të kryenin sa më mirë të gjitha detyrat. Forcat e Qendër së Asgjësimit të Municioneve me Eksploziv punuan në segmentin Beltojë Bushat në kushtet e motit me shi dhe të ftoftë duke pastruar mbi 10 ton mbeturina të cilat kishin vite që ishin hedhur dhe dekompozuar në dyja anët e rrugës në kanalet e kullimit të këtyre rrugëve. Po ashtu dhe përmbytjen në vite kishin dekantuar shumë mbeturina të cilat kishin bërë një ndotje shumë të madhe të mjedisit dhe ishin bërë problem për banorët për rreth rrugës. Në këtë operacion u punua për rreth 8 orë dhe në këtë segment punën nga afër e ndoqi dhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Viktor Berdo, i cili ishte dhe udhëheqësi i aksionit direkt në terren. Po ashtu

**OPINION**

**"FA janë të parat që po japin një impakt ndërgjegjësimiti mbarë-shoqëror"**

"Së pari, vlerësoj maksimalisht angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në përballimin e emergjencës mjedisore, e cila po jep një impakt pozitiv në zgjimin e një ndërgjegjësimiti mbarë shoqëror. Shembulli që po jep ushtria është modeli më i mirë që ofrohet sot për të siguruar një ambient tërësisht dhe gjithnjë të pastër. Nuk është hera e parë që ushtria me modestinë e saj, tregon modelin më të mirë për të bërë realitet atë që thuhet dhe për më tepër të konkretizojë rezultatet në kohë rekord dhe me cilësinë e duhur. Për më tepër Forcat e Armatosura janë të parat që po veprojnë në terren në përkrahje të nismës "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër". Ishte fat për ne që në qarkun e Lezhës u angazhuan forcat elitë të ushtrisë, si Forcat Speciale, Forcat Komando, Forcat e Policisë Ushtarake, të ASNI-së, etj. Imazhi që ju dhatë në Lezhë ishte një pikënisje për të ndërgjegjësuar masën e gjerë qytetare në këtë qytet që të kontribuojnë me të njëjtin model. Kush ishte në terren e pa qartë se popullata, veçanërisht në qytet tregoi gatishmërinë për t'iu përgjigjur me të njëjtën monedhë ushtrisë. Duke shprehur mirënjohje për punën dhe ndihmën e dhënë, e shoh me vend se aktivitetet të tilla jo vetëm që ndihmojnë procesin siç është përballimi i emergjencës ambientale, por edhe një mundësi e

mirë për integrim të strukturave civile dhe atyre ushtarake për ti shërbyer sa më mirë vendit. Ky aktivitet shërbeu si masë përgatitore për të qenë të gatshëm për përballimin e situatave të tjera të emergjencave të mundshme që mund të shkaktohen nga natyra apo njeriu. Gjej rastin të përcjell nëpërmjet gazetës ushtria, një falenderim të përzemërt për drejtuesit kryesor të Mbrojtjes, ministrin Mimi Kodheli, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo që janë në krye të kësaj veprimtarie rehabilituese të mjedisit. Në mënyrë të veçantë dua të përgëzoj ata që vepruan drejtpërdrejt në pastrimin e ambientit, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, me shembullin e të cilëve i ndryshuan faqen aksit Milot - Lezhë. Tani mbas kësaj pune të shkëlqyer tuajën është detyrimi ynë ta mbajmë pastër mjedisin. Kjo mendoj se do të arrihet jo vetëm nëpërmjet masave ndërgjegjësuuese, por edhe aplikimin e masave administrative, si për organizmat shtetërorë ashtu dhe ato privat, në mënyrë të veçantë ndaj kompanive të ndryshme, që operojnë në prefekturën tonë. Është detyrimi i çdo qytetari, të mos krijojë ndotje të ambientit, në të kundërt, do ti nënshtrohet sanksioneve me masa dëmshpërblyese." – thotë zoti Altin Jaku, sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, Lezhë. N.B.



trupat i inspektoi dhe ndihmoi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili ndoqi nga afër këtë aksion dhe në përfundim falenderoi me anë të një letre qarkoreje tërë trupat pjesëmarrëse. Në këtë operacion një rol të rëndësishëm luajtën masat paraprake që ishin marrë nga ana e komandës së brigadës logjistike për gatishmërinë e mjeteve të transportit të forcave dhe të plehrave, por dhe nga masat që të gjitha trupat pjesëmarrëse të ishin të pajisura me maska me doreza dhe me thasë plasmasi apostafat për plehra. Të gjitha plehrat e paketuara u nxorën në dy anët e rrugës dhe pastaj u ngarkuan në makina transporti dhe u dërguan në Lamfilldin e Bushatit. Qendra e aksionit ku ishte vendosur dhe çadra e aksionit shërbeu dhe si vendi ku jepeshin detyrat dhe u bënë të gjitha takimet me drejtuesit e pushtetit vendor. Të 25 forcat e QAM punuan me kujdes dhe në vështirësi të mëdha, pasi dy anët e rrugës janë të veshura me ferra dhe me kanale uji dhe arritën që ti pastronin ato. Po ashtu dhe 20 trupat e Batalionit të Transportit punuan me shumë kujdes dhe me përgjegjësi pasi në rrugë kishte shumë trafik intensive dhe duhej bërë puna në kohë të keqe dhe sa më shpejt. Komanda e shtabit e drejtuar nga kapiten Bledion Dule punoi me shumë përkushtim dhe përdori lopata, kosa dhe kazma për të larguar plehrat dhe mbeturinat në dy anët e rrugës së Drinit në hyrje të Shkodrës ku ishte dhe rajoni më i ndotur dhe më i vështirë për tu pastruar në tërë segmentet

që pastruan Forcat e Armatosura. Kjo zonë ishte me shumë banesa intensive në biznes dhe ishin çliruar prej vitesh shumë mbeturina, të cilat u grumbulluan në thasë dhe u transportuan. Gjeneralbrigade Syrja Gjoka tha se ky aksion vërtetoi dhe një herë gatishmërinë e kësaj brigade, rolin e saj që luan në Forcat e Armatosura, përgjegjësinë për detyrën, përkushtimin, organizmin, dhe disiplinën e trupave, por dhe ndihmën që u kemi dhënë dhe u japin komunitetit sa herë që na kërkohet. Ai vlerësoi punën e tërë efektivit që drejton dhe gjatë gjithë kohës së aksionit punoi vetë dhe ishte në krye të trupave duke inspektuar dhe ndihmuar atje ku punët ishin të vështira dhe kishte problem për shkak të sasisë së madhe të plehrave. Edhe autoritet e pushtetit lokal falenderuan të gjithë trupat pjesëmarrëse në këtë operacion që vërtetoi dhe një herë sa e organizuar, sa e disiplinuar është një repart i FA. Të gjithë forcat pjesëmarrëse vërtetuan se dinë të marrin përgjegjësi. Segmenti që ata pastruan ishte shumë i ndotur. Ata premtuan se janë gati u përgjigjen tërë operacioneve të ngarkuara nga komanda eprore për aksione në ndihmë të komunitetit. Maks Oranlliu që ishte direkt në këtë operacion tha se ishte shumë i organizuar dhe kolanat e marshimit jo vetëm në vajtje, por dhe në kthim ishin korrekt, të disiplinuar dhe vepruan me saktësi. Ndërsa kolonel Besnik Sylaj që kishte bërë dhe rikonicionin dhe përcaktimin e tërë masës së plehrave një ditë më parë, i ndau me shumë saktësi duke bërë llogari të përpikta me të gjitha forcat.

**ANO përfaqëson denjësisht KDS-në dhe FA në nismën e pastrimit**

Më datë 08.02.2014 Akademia e Nënoficerëve "Thomson" mori pjesë në operacionin në ndihmë të komunitetit për pastrimin e territorit të Shqipërisë, si rezultat i emergjencës kombëtare të shpallur nga Qeveria për shkak të ndotjeve dhe mbetjeve të shumta urbane dhe inerte që rrezikojnë përhapjen e epidemive të ndryshme në vendin tonë, me qëllim sensibilizimin e opinionit publik dhe dhënien e kontributit "Për një Shqipëri të pastër". ANO përfaqësoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvtjes dhe vet FA duke kontribuar në pastrimin e territorit të Prefekturës/Qarkut Shkodër, në rrugëkalimin Ura e Bunës - Shirokë, gjatësi kjo prej 5 km. Për zhvillimin e operacionit u angazhuan 60 forca, kursantë të Kursit Fillestar dhe të Avancuar të Akademisë së Nënoficerëve. Zv/komandanti dhe aktualisht komandanti në detyrë i ANO, n/ kolonel Muhamed Guza qe prezent gjatë gjithë aksionit të së shtunës së parë për pastrimin e territorit të vendit tonë duke drejtuar e mbajtur nën mbikëqyrje punën e palodhur të të gjithë kursantëve që ndihmuan në pastrim. Ky aksion u ndoq me një vëmendje të veçantë edhe nga zv/ komandanti i KDS-së, kolonel Ruzhdi Kuçi, shefi i Shtabit të KDS-së kolonel Riza Zaja dhe shefi i Degës së Operacioneve në KDS n/kolonel Shpresim Shllaku, të cilët ndoqën nga afër aksionin për të siguruar një mbarëvajtje sa më të mirë të tij. Operacioni u zhvillua në dy faza. Gjatë fazës së parë u morën të gjitha masat e nevojshme parapërgatitore për kryerjen me sukses të misionit, si: kryerja e përnjohjes, përcaktimi i detyrave, përgatitja e bazës materiale për punë, mjeteve, mbështetja logjistike, përcaktimi i pikave për grumbullimin e mbeturinave dhe vendin e zhvendosjes së tyre etj. Gjatë fazës së dytë u krye lëvizja për në rajonin e caktuar ku dhe u bë përmbushja e misionit për pastrimin e rrugëkalimit Ura e Bunës - Shirokë. Në përfundim të operacionit u mblodhën rreth 16 ton mbeturina, të cilat u transportuan me Kamionë në Landfillin e Bushatit për asgjësim. Operacioni u krye me sukses në ditën e parë të tij dhe ndikoi dukshëm në ndërgjegjësimin e komunitetit ku u bë pastrimi, gjë që u vu re dhe nga ndihma e dhënë nga një pjesë e banorëve të komunitetit dhe fjalëve pozitive të tyre për punën e FA. M. H.



# “Terminologjia e hapësirës ajrore”, zhvillohet trajnim me amerikanët

Përfaqësues të “Komandës Amerikane të Forcave Ajrore në Evropë” zhvilluan në ambientet e komandës së Forcës Ajrore një aktivitet trajnues në fushën e terminologjisë së hapësirës ajrore, të quajtur “Aerospace Terminology”. Në kuadër të bashkëpunimit me Komandën Amerikane të Forcave Ajrore në Evropë, në ambientet e Komandës së Forcës Ajrore në datat 10 dhe 11 shkurt 2014 u zhvillua një aktivitet trajnues në fushën e terminologjisë së hapësirës ajrore. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte familjarizimi i personelit ushtarak dhe civil të kontrollit të trafikut ajror me parimet bazë të terminologjisë së hapësirës ajrore që përdoret në Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara, për të përmirësuar ndërveprueshmërinë kur menaxhohen avionët të NATO-s dhe të Shteteve të Bashkuara. Ekipi amerikan përbëhej nga katër ekspertë të fushës së trafikut dhe mbrojtjes ajrore të cilët shërbejnë në Grupin e 435-të të Përgjigjes/Reagimit ndaj Emergjencave të paparishikuara (435th Contingency Response Group) pjesë e Komandës së Forcave Ajrore Amerikane në Evropë. Në këtë aktivitet trajnues nga pala shqiptare morën pjesë personeli ushtarak i kontrollit të trafikut ajror të Forcës Ajrore si dhe kontrollorë civilë të agjencisë Alb Control. Aktiviteti trajnues filloi me një vizitë mirëseardhjeje me komandantin e Forcës Ajrore gjeneralbrigade Frederik Beltoja. Në këtë takim u shprehën objektivat e këtij aktiviteti trajnues si dhe mundësia e bashkëpunimit

për të ardhmen. Një nga çështjet për të cilat u kërkua bashkëpunimi lidhet me asistencën nga pala amerikane për rishikimin e master planit të Bazës Ajrore Kuçovë. Më pas u vijua me aktivitetin trajnues mbi terminologjinë e hapësirës ajrore. Fillimisht nga Komanda e Forcës Ajrore u paraqit një prezantim mbi misionin, detyrat dhe planet për modernizimin e Qendrës së Vëzhgimit Ajror në kuadër të integritetit të plotë në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s (NATINAMDS). Ekspertët amerikanë trajtuan çështjet bazë për terminologjinë e trafikut ajror, misionin e Grupit të 435-të Përgjigjes/Reagimit nga Emergjencave të paparishikuara, strukturën e re të komandimit kontrollit ajror të NATO-s, sistemet dhe linket taktike të të dhënave që përdoren nga forcat amerikane në Shtetet e Bashkuara si dhe shpërndarjen e Qendrave të Operacioneve Ajrore Amerikane dhe ato të NATO-s, Diskutime dhe pyetje të ndryshme u zhvilluan nga kontrollorët e trafikut ajror civil në lidhje me terminologjinë dhe procedurat që ndiqen kur kontrollohen dhe menaxhohen avionët ushtarakë. Misioni i këtij Grupi është të hapë Baza të reja Ajrore në zonat ku ka emergjenca, kryerja e studimeve, analizave për aerodromet, parkimet e avionëve, vendosjen e kapaciteteve të partneritetit. Mision tjetër, i veçantë i këtij Grupi është : trajnim i personelit para dislokimit në zonën e emergjencës/ teatrin e luftimeve, mbështetje e luftimit me forca xheniere. Në përfundim



të aktivitetit, për bashkëpunimin në të ardhmen u kërkua nga ekipi amerikan të planizohet një vizitë më e gjatë për të kryer një vlerësim më të detajuar të Bazës Ajrore Kuçovë, me qëllim që të merren rekomandimet e ekspertëve amerikanë për përmirësimin e master planit dhe punimeve në këtë bazë. Gjithashtu ekspertët amerikanë dhanë asistencë në lidhje me trajnimet e mundshme që mund të ndiqen në shkollat amerikane të mbrojtjes ajrore dhe trafikut ajror, nga personeli ushtarak shqiptar.



## Delegacioni ushtarak turk, vizitë në Batalionin e Forcave Speciale dhe Batalionin Komando

Në kuadrin e bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, një delegacion i nivelit të lartë i FA turke i kryesuar nga gjeneralletenant Mehmet Daysal, zhvilloi një vizitë në batalionin e Forcave Speciale të Forcës Tokësore. Qëllimi i vizitës ishte njohja me zhvillimin e Forcave Speciale dhe batalionin Komando. Gjeneralmajor Dushku, pasi ju uroi mirëseardhjen delegacionit ushtarak turk në batalionin e Forcave Speciale dhe batalionin Komando, i njohu ata me strukturën dhe zhvillimin e Forcës Tokësore (FT). Ai vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer midis FA shqiptare dhe FA turke, si kontribuuese për sigurinë dhe paqen në

botë. Gjatë takimit gjeneral Dushku vlerësoi kontributin e dhënë nga FA turke për FA shqiptare, përfshirë këtu FT e në veçanti e fokusuar kjo në batalionin e Forcave Speciale dhe batalionin Komando, në fushën e arsimimit, asistencës teknike për trajnimin e trupave dhe mbështetje logjistike, mbështetje e cila ka ndikuar drejtë për së drejti në rritjen e nivelit të profesionalizmit. Aktiviteti vijoi me një briefing njohës dhe informues mbi batalionin e Forcave Speciale dhe batalionin Komando, në lidhje me misionin, detyrat që realizojnë, stërvitjet e zhvilluara, kompletimin me pajisje, angazhimin me misione jashtë vendit, si dhe kontributin e dhënë nga FA turke për këto reparte të Forcës Tokësore. Në emër të delegacionit turk,

gjeneralletenant Mehmet Daysal shprehu falënderime për mikpritjen dhe informacionin e ofruar dhe njëkohësisht vlerësoi arritjet e të dy batalioneve, përfshi edhe angazhimet në misione. Ai theksoi se ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen. Më pas të pranishmit ndoqën një demonstrim stërvitor nga të dy batalionet, i fokusuar në patrullim me mjete max-pro, qitje të llojeve të ndryshme (transition, me precizion, qitje shpejtësie, me snajper), si dhe kontroll objekti, operacione në godinë, veprime në pritë, mbijetesë, veprime në kullën e alpinizmit, etj. Në përfundim të demonstrimit gjeneralletenant Mehmet Daysal, falënderoi trupat për performancën e treguar, shkallën e lartë të përgatitjes dhe për suksese në të ardhmen.

## Ekspertët amerikanë, diskutim mbi përballimin e emergjencave detare

Ekspertë të SHBA për emergjencat civile, vizitojnë Komandën e FD, QNOD dhe institucione të tjera në Portin e Durrësit

Në zbatim të programeve të bashkëpunimit midis qeverisë shqiptare dhe Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, një grup ekspertësh të SHBA për operacionet e emergjencave civile dhe antitrafik, më datën 11 shkurt 2014, vizituan institucione të ndryshme detare në Durrës. Fillimisht ekspertët e SHBA zhvilluan një takim në Komandën e Forcës Detare ku u pritën nga shefi i Shtabit i FD, kapiten i rangut të II-të Adnan Agastra dhe kuadro të Degës Operacionale të FD. Gjatë takimit u diskutuan gjerësisht për mundësitë e kapacitetet operacionale të FD për përballimin e emergjencave detare në hapësirën ujore të vendit tonë, konkretisht vendbazimet kryesore të FD, anijet e mjetet në dispozicion, të dhënat e tyre taktiko-teknike, si organizohen patrullimet, marrja dhe shkëmbimi i informacionit nëpërmjet QNOD, stërvitjet e ndryshme për përballimin e emergjencave civile, mbajtja e regjimit në ujërat liqenore. Gjithashtu u diskutua për aftësitë profesionale të zhytës tanë, trajnimin e tyre, bashkëpunimi me zhytësit e RENE-s. Kontrolli dhe monitorimi i mjeteve të peshkimit, personeli i bordingut, struktura ku bën pjesë, aftësitë e këtij grupi. Shefi i shtabit i FD, kapiten Agastra theksoi se, po punohet për shtimin e kompetencave të grupit të bordingut dhe trajnimin e tyre me Forcat Speciale në Zallherr gjatë këtij viti. U nënvizua domosdoshmëria e planeve të veçanta në raste cunami, tërmeti, zjarrit në anijet e transportit e pasagjerëve, kapacitetet operacionale të FD për komunitetin, sipas urdhrave dhe linjës, stërvitjet në raste fatkeqësie, parandalimi i trafikëve dhe kontrabandës, operacionet e Policisë kufitare dhe FD në këto raste, roli i Qendrës Operacionale, etj. Lajm i mirë gjatë takimit ishte puna që po bëhet për rivendosjen në punë të QVD brenda muajit shkurt të këtij viti. Ekspertët e SHBA vlerësuan punën që po bëhet për reformimin, modernizimin dhe shtimin e kapaciteteve operacionale të strukturave të FD. Mbas takimit në FD, grupi i ekspertëve të SHBA zhvilloi një vizitë në Qendrën tonë Ndërinstitucionale Operacionale Detare ku u pritën nga drejtori i kësaj Qendre Maksim Malaj dhe koordinorët e institucioneve pjesëmarrëse. Fillimisht nëpërmjet një prezantimi, ekspertët u njohën me strukturën, institucionet përbërëse, misionin, detyrat dhe operacionet e kryera nga QNOD gjatë vitit të kaluar. Në vijim specialistët shqiptarë dhe të SHBA diskutuan për rolin e çdo institucioni pjesëmarrës dhe nivelin e tyre të bashkëpunimit, asetet në dispozicion, legjislacionin përkatës, procesin vendimmarrës gjatë operacioneve detare, ekzistencën e procedurave standarde, analizën dhe nxjerrjen e mësimave pas çdo operacioni, bashkëpunimin me dikasteret e tjera, psh. Ministrinë e Jashtme, Qendrën Kombëtare të emergjencave civile, etj. Gjatë vizitës në Sallën Operacionale u prezantuan sistemet e vëzhgimit të hapësirës detare, ndjekja e situatës detare nga operatorët dhe personeli i shërbimit, mënyrat dhe mjetet për shkëmbimin e informacionit, kontrollin e anijeve veçanërisht ato të peshkimit para daljes në det dhe kthimit në mol, pajisja e tyre me mjetet sinjalistike dhe të komunikimit sipas standardeve ndërkombëtare, bashkëpunimin rajonal dhe mundësitë e zgjerimit të tij në të ardhmen. Ekspertët e SHBA vlerësuan punën dhe rezultatet e deritanishme të QNOD në ndjekjen e situatës detare dhe zbatimin e ligjshmërisë brenda kufirit blu si dhe eksperiencën e krijuar për bashkëpunimin e institucioneve që kanë interesa në det. Në zbatim të programit po këtë ditë, ekspertët amerikanë të emergjencave detare vizituan dhe institucione të tjera në portin e Durrësit.





## Në 2014, janë planëzuar dyfishi i stërvitjeve të 2013-s

Flet nënkolonel(r) Vladimir Bullari, oficer për përgatitjen e skenarëve të forcës kundërshtare

Ladi është nga të parët në këtë qendër dhe bashkë me palën amerikane ai është një prej ideatorëve që skicuan projektet që në fillim dhe më pas është bërë zbatimimi e krijimi i qendrës. Projekti filloi në vitin 2009, por hovin më të madh e filloi në janar të vitit 2011. "Fillimisht u bë përzgjedhja e personelit për këtë qendër simulimi dhe çdo gjë u mbështet si nga KDS edhe nga SHP dhe u vu në dispozicion personeli i cili kaloi në një filter testimi nga ne dhe pala amerikane. Pasi plotësuan kriteret që duheshin për secilin funksion, pas tre muajsh u bë plotësimi me personel që plotësonte kriteret që duheshin për vendin e punës. Sot jemi në këtë gjendje, ku QS në vitin 2013 nga gjashtë stërvitje të planëzuara zhvilloi tetë dy stërvitje ishin cilësore dhe plus, "Joint Reaction" me vendet e rajonit dhe tjetra ishte për togën e PU në kuadrin e vajtes së tyre në stërvitje të NATO-s në Poloni." - tregon nënkolonel(r) Vladimir Bullari, oficer për përgatitjen e skenarëve të forcës kundërshtare. Pra viti 2013 shërbeu si periudhë bazë shumë e mirë për ta konsoliduar këtë qendër simulimi për vitin 2014. Kështu, në vitin 2014 janë të planëzuara 14 stërvitje për vitin, një sasi dy herë më e lartë se viti 2013. "Sasia e stërvitjeve të planëzuara për vitin 2014, do të thotë se duke pasur parasysh metodologjinë e planëzimit dhe

zhvillimit të një stërvitje sipas standardeve të kësaj qendre, volumi i punës është vërtet i madh. Në këtë periudhë do të zhvillohet gjithashtu edhe trajnimi i vetë personelit të qendrës me qëllim rritjen e profesionalizimit të përdorimit të programeve kompjuterike të përdorimit dhe të aftësisë së planëzimit dhe të zhvillimit të një operacioni. QS sa po vjen dhe po konsolidohet si në kuptimin e personelit edhe në zbatimin e procedurave standarde që aplikohen në të gjitha vendet e NATO-s. Kjo është një qendër që ka një vizion të qartë për të ardhmen: di ku do të shkojë dhe di se si do të shkojë. Kjo qendër është gjithnjë në rritje dhe ka një personel që është i motivuar dhe ky i fundit është një personel i ri ku grada më e lartë është grada major dhe pjesa tjetër kapiten. Ata kanë një nivel të krahasuar me gradën nënkolonel, për shkak se vetë planëzimi që zhvillohet në këtë qendër për stërvitjet e llojeve që u përmendën, u mundëson atyre që të fitojnë njohuri të gjëra. Për suksesin është bërë një punë e pamohueshme nga personeli, por nuk duhet harruar edhe mbështetja e SHP, KDS si dhe e palës amerikane nëpërmjet përfaqësuesve të CUBIC, të cilët janë prezent që nga momenti i parë e deri sot, si me trajnimet edhe me mbështetjen logjistike në këtë qendër.

## "Kemi një qendër simulimi që ofron shërbime të plota"

Flet Dee Esplin, Përfaqësuesi i Ekipit të CUBIC, në QS

Ai është i ngarkuar me dy gjëra: të përgatisë stafin qendrës në mënyrë që të drejtojnë një qendër simulimi e cila të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe e dyta, që ka lidhje me çështjen e parë, është zhvillimi i trajnimit të cilësisë së lartë për FARSH, të zhvilluar sipas standardeve të NATO-s. Kjo ka qenë dhe do të jetë edhe në të ardhmen, për aq kohë sa do të vazhdoj bashkëpunimi dhe asistenca amerikane në këtë qendër, puna dhe fokusi i ekspertit amerikan, Dee Esplin. Ndërkohë, në vijim, ai na tregon disa detaje mbi rëndësinë dhe ecurinë e qendrës.

"Është hera e tretë ose e katërt që unë ndihmoj në krijimin e një qendre simulimi. Mendoj dhe jam i di të them që kjo qendër përfaqëson praktikën më të mira të mësimetve të nxjerra, të Forcave Tokësore, Marinës amerikane dhe shumë vendeve të tjera të NATO-s, gjatë 25 viteve të fundit. Ne i kemi sjellë këto praktika të mira këtu dhe kjo është ajo që po mendohejmë të krijojmë në këtë qendër. Mendoj se kemi një qendër simulimi që ofron shërbime të plota dhe ne i mbulojmë të gjitha pjesët e rëndësishme të trajnimit. Kemi stafin që merret me gjërat teknike, kompjuterike, simulimin, por gjithashtu kemi edhe ata që merren me planëzimin dhe skenarët,

ku vëzhguesit vëzhgojnë trajnimin, analiza, vlerësimet etj. bazuar te mësimet e nxjerra nga SHBA dhe vende të tjera për trajnimin. Sipas vlerësimit tim, kjo qendër është kapaciteti trajnues më i rëndësishëm që kanë FARSH për trajnimin e komandantëve dhe drejtuesve. Një gjë e mirë për simulimin është se na lejohej që të bëjmë gjëra me më pak kosto se sa në terren. Për sa i përket të ardhmes, shpresa ime më e madhe është që të gjenden burimet për të vazhduar atë që ne po bëjmë, pasi ne kemi ende punë të rëndësishme për të bërë. Stërvitja në terren është e shumë e domosdoshme, por këtu mund të bëhen shumë gjëra para se të bëhen në terren. Nga përgatitja akademik, vihet këtu, trajnohen drejtuesit e trupat e mandej ata shkojnë në një qendër trajnimi, në një poligon, si p.sh. në Bizë dhe ata i vënë aty në praktikë të gjitha ato që u mësuan këtu. Nëse bëhet një stërvitje në terren, mund të llogaritet lehtë se sa bën kostoja e thjesht një fisheku dhe të shihet se këtu, nëpërmjet simulimit të spostimit të mjeteve, përdorimit të armëve etj, nuk ka kosto. Sidoqoftë, dallimi në vendimet që merren nuk ekziston dhe këto stërvitje janë më efektive" - thotë Dee Esplin, Përfaqësuesi i Ekipit të CUBIC, në QS.

# "Qendra e Simulimit", vizion i qartë dhe konsolidim i dukshëm

ALBERT HITOALIAJ

Në prioritetet e SHP, "Qendra e Simulimit" qëndron edhe për këtë vit si motori i stërvitjeve të përbashkëta si brenda FA edhe për ato stërvitje ndërinstucionale, si p.sh. në ato raste kur ka pasur pjesëmarrje deri në shtatë ministri. Misioni i QS, është planëzimi, organizimi dhe zhvillimi i stërvitjeve të mbështetura me kompjuter. Ky mision ka shërbyer për përgatitjen e personelit të komandave dhe shtabeve. QS ka treguar të jetë një histori suksesi në kryerjen e këtij misioni. Metodën e aplikuar në këtë qendër kanë intensifikuar përmirësimin e gjendjes, veçanërisht në stërvitjen e shtabeve, aftësinë drejtuese të komandave etj, gjë e cila ka bërë edhe standardizimin e këtyre stërvitjeve duke sjellë të njëjtat standarde me të cilat zhvillohen stërvitjet edhe në ushtrinë amerikane. Vijimi i stërvitjes së personelit të FA për njohjen e përdorimit praktik të programeve kompjuterikë të kësaj qendre, është një nga sfidat kryesore të vitit 2014. Nxjerrja e mësimetve pas stërvitjeve të kryera në këtë qendër, për përmirësimin dhe arritjen e objektivave më të larta mbeten objektivi parësor dhe kryesor i kësaj qendre. Për këtë qëllim, viti 2014 do të jetë shumë më i ngarkuar me punë, pasi disa prej stërvitjeve zhvillohen për herë të parë si p.sh. stërvitja "Pulëbardha 2014", e cila do të zhvillohet me QNOD dhe do të shohë në përbërje të vetën institucionet e ministrisë së Mbrojtjes, së Brendshme, së Turizmit, Transportit, Ekonomisë, Infrastrukturës, Kulturës, Financës. Qëllimi kryesor i kësaj stërvitje është rritja e ndërveprueshmërisë së këtyre institucioneve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre dhe operimi në mënyrë sa më të shpejtë që të jetë e mundur kundër trafikëve. Një tjetër stërvitje e rëndësishme, është edhe stërvitja "Skifteri" që do të zhvillohet në qershor, me Akademinë e FA me të tre nivelet e Kurseve. Stërvitje të tjera do të



### Pika të rëndësishme të stërvitjes simuluese

- Dikur bëheshin stërvitje me harxhime të mëdha, ndërsa QS jep mundësinë të bëhen me një kosto shumë më të ulët.
- Trajnimi mundëson rishikimin e veprimeve nëse ato bëhen gabim.
- I shërben si qendër, jo vetëm shtabeve për nivel vendimmarrje, por edhe niveleve më të ulëta.
- Mundëson trajnim para misioneve për mjedisin ku do dislokohen trupat.
- Stërvitja simuluese i shërben stërvitjes së terrenit, duke ulur koston dhe kohën për të arritur objektivat.

ndiqen nga ANO, Kursi i Bazë i Nënoficerëve, Kursi i Avancuar i Nënoficerëve dhe ato do të jenë stërvitjet "Shkumbini" në mars dhe "Tufina" në maj. Një tjetër stërvitje është ajo "Rozafa" me SHP dhe stërvitja "Radhima" me QBO - qëllimi është standardizimi i koordinimit midis forcës ajrore, tokësore dhe detare. Një tjetër pjesë e stërvitjes "Radhima" do të jetë edhe përdorimi i aseteve të kërkimit shpëtimor brenda skenarëve të mundshëm. Gjithashtu, do të zhvillohet për herë të parë edhe një stërvitje me pesë batalionet e FT, ku risia është se për herë të parë, të pestë batalionet zhvillojnë një stërvitje të përbashkët.

"I gjithë planëzimi i stërvitjeve të programuara, është mbi bazën standarde të procedurave të NATO-s, kryesisht ato amerikane. Kemi zhvilluar dhe vazhdojmë të zhvillojmë në mënyrë të vazhdueshme takime me AFA, me

komandantin e AFA prof. Sula dhe me departamentin e operacioneve që drejtohet nga kol. David Rroku, ku qëllimi i vetëm ka qenë standardizimi i metodave të planëzimit në nivel taktik dhe operacion, pasi në momentin që flasim FA përdorin disa manuale të ndryshme. Për këtë qëllim, së bashku me ekipin amerikan, të drejtuar nga Dee Esplin, dhe dy kolegët e tjerë të mrekullueshëm, Antonio dhe Toni, me qëllim standardizimin e këtyre manualeve dhe ripunimin e një manuali të vetëm unik, që të përdoret nga të gjitha institucionet arsimore të KDS-së. Për këtë qëllim kemi zhvilluar takime jo vetëm me AFA, por edhe me pjesëtarë të ANO. Takim tjetër i realizuar nëpërmjet iniciativës së bashkëdrejtuesve tanë amerikanë të qendrës, është edhe takimi me drejtuesin e Qendrës së Doktrinave, kol. Ahmet Leka, pasi ata janë përgjegjës për krijimin e materialeve doktrinarë në nivelin strat-



### Risi për 2014

- Në vijim çdo stërvitje të zhvillohet në terrene të ndryshme.
- Shumëllojshmëri dhe skenarë të ndryshëm me qëllim standardizimin e veprimeve me ato të NATO-s
- Do i kushtohet rëndësi zbatimit të eksperiencës së fituar në Irak dhe Afganistan.
- Pjesa më e madhe e skenarëve do të jetë nga territori i Shqipërisë.
- Testimi i kapaciteteve për të parë përshtatjen në skenarë të ndryshëm.

egjik, operacional-teknik dhe specifik. Për këtë qëllim së bashku me AFA, ANO, KDS, Qendrën e Doktrinës, janë zhvilluar një sërë takimesh me të vetmin qëllim: standardizimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë drejtim do të doja të falënderoja në mënyrë të veçantë, një nga komandantët tanë, nënkolonel (r) Vladimir Bullarin, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer dhe pa dyshim ka qenë motori i funksionimit të QS, duke mundësuar mirëfunksionimin si të degës së Operacioneve edhe degës së Teknikës, degë të cilat kanë pasur një ngarkesë të jashtëzakonshme në këto vite me qëllim realizimin me sukses të këtyre stërvitjeve. Vlen të përmendim si nga më të dalluarit, kapiten Julian Myteberi, major Mevlan Gaxhe, major Lulzim Salihu, major Armand Rrepa, nëntogere Shqipe Ndreaj dhe padyshim shumë e shumë të tjerë që kanë bërë një punë të shkëlqyer. Ambicjet e QS

janë akoma më të mëdha për vitin 2014 dhe për 2015, me qëllim që stërvitje ndërkombëtare si "Adriion Cax 2015", e cila do të jetë nga më të mëdhatë, me pjesëmarrjen e disa shteteve, të zhvillohet në mënyrë të suksesshme. Kjo stërvitje do të zhvillohet në kuadrin të iniciativës Adriion. Gjithashtu ka edhe një stërvitje tjetër të rëndësishme përpara, stërvitja "Joint Reaction 2015" e cila do të zhvillohet mes vendeve të Evropës Juglindore. Në këtë stërvitje do të ketë një pjesëmarrje nga vendet e rajonit e më gjerë. Normalisht që, me qëllim arritjen e rezultateve sa më pozitive të punës së kësaj qendre duhet bërë edhe sistemimi me ambiente, sigurimi i infrastrukturës mbështetëse të domosdoshme, sigurimi i mirëmbajtjes së pajisjeve etj gjëra që deri tani nuk janë realizuar plotësisht" - thotë për gazetën "Ushtria" drejtori i "Qendrës së Simulimit", kolonel Dritan Demiraj.



# OFFA,

## kryefjala e pritjeve ceremoniale dhe jetës artistike

*Flet për gazetën "Ushtria", Arben Muça,  
udhëheqësi artistik i Orkestrës Frymore së Forcave  
të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*

Intervistoi: Alba Musaraj

**O**FFA konkurren denjësisht me Orkestrën e Operës dhe të Radiotelevizionit si dhe është në lartësinë e duhur me homologët e saj në botë, pasi tashmë ajo zotëron të gjitha burimet për të qenë më efikase dhe në zhanret e tjera të muzikës, si asaj të dhomës, fanfarave të ndryshme që operojnë në të gjithë spektrin e muzikës. OFFA, tashmë me një frymë të re në gjirin e saj, do të jetë shembull me punën e saj në përmbushjen e misionit që ka duke mbuluar veprimtaritë protokollare dhe ato jo-protokollare, koncertore-festive, ushtarako-sportive, etj. Misioni i kësaj orkestre nuk ka mbaruar, përkundrazi ajo do të ketë një tjetër prezantim në jetën artistiko-kulturore të vendit, ku do të shpalojë vlerat e mbarura ndër vite.

**Mund të më thoni se cilat janë datat kryesore të koncerteve që do të zhvillojë OFFA gjatë vitit 2014?**

Duke hapur stinën koncertore ne u shfaqëm në një televizion i cili është sa publik edhe privat, sepse është pjesë e botës mbarë shqiptare. Gjithmonë duhet të kemi parasysh që OFFA, e cila është një formacion artistiko-muzikor unik në këtë Forcë të Armatosur dhe bën ceremonialin shtetëror, është kryefjala e pritjes së personaliteteve dhe komplet aktiviteteve të ndryshme ceremoniale zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të shtetit në përgjithësi. Së shpejti, kemi një koncert mjaft të bukur me formacionet e vogla artistike, që është një sekstet harqesh, sekstet i saksave dhe një kuintet fryme, të cilët do të performojnë live në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operës e Baletit në sallën e koncerteve, datë e cila pritet të vendoset së shpejti. Këtu orkestra do të performojë me 3 lloje veshjesh, të 3 llojet e Grand Uniformave, do bëhet një ekspozitë e OFFA ndër vite në bashkëpunim me QKMBM, bashkëpunim i cili është i pashmangshëm, sepse jemi pjesë kulturore-artistike dhe QKMBM është vlerë për institucionin e MM. Për herë të parë aty do të luhen dhe këngë shqiptare, pjesë të ndryshme klasike. Kjo

**Formacioni i parë zyrtar i Bandës Shqiptare u krijua gjatë viteve 1912-1915. Gjatë viteve 1928-1939, u formua formacioni i parë profesionist-artistik i quajtur Banda e Gardës Kombëtare dhe më pas Banda Mbretërore. Orkestra Frymore e Ushtrisë u krijua në tetor të vitit 1944 në fshatin Priskë pranë kryeqytetit (Tiranë) dhe kishte si personel artistik rreth 25 instrumentistë, muzikantë partizanë si dhe ish-pjesëtarë të bandave të krijuara gjatë viteve 1928-1939.**

do të jetë diçka shumë e bukur për aktivitetin e mesit të muajit shkurt. Ndërsa në muajin prill do të zhvillojmë një koncert premierë nga nënkolonel Halim Teqja, dirigjenti i Orkestrës Frymore, i cili do të bashkëpunojë dhe me një solist tjetër e do ketë disa vepra të përzgjedhura. Këto janë pritshmëritë e afërta.

Përsa i përket datave kryesore të koncerteve kemi vendosur me anë të Këshillit Artistik disa data, siç është për shembull 14 shkurti, koncert me rastin e festës së dashurisë; 14 marsi, ku do të kemi kolonën zanore të filmave shqiptarë në Big Band, e sinkronizuar me pamje nga filmat në ambientet të cilët do të përzgjedhim dhe në bashkëpunim me QKMBM; 2 prilli, koncert me rastin e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO; 30 prilli, që është koncerti i muzikës xhaz dhe rëndësisë së tij nga formacioni i saksave, të cilët do të performojnë në bashkëpunim me QKMBM, 21 qershori, ku do të kemi një koncert me vepra shqiptare në kuadër të ditës botërore së muzikës tradicionale, i cili bëhet në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës, Medias e Botimeve të Mbrojtjes, 1 tetori, dita e muzikës klasike, pra nga formacioni i harqeve po në bashkëpunim me QKMBM; 4 dhjetori, ku do të zhvillohet

koncert me rastin e krijimit të Forcave të Armatosura. Duhet të jemi të qartë se çdo dokumentacion i detajuar për këto lloj koncertesh është bërë me matricë dhe nga Këshilli Artistik i servivet dhe Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes.

**Cili është misioni dhe cilat janë detyrat e OFFA?**

Misioni dhe detyrat e Orkestrës Frymore së Forcave të Armatosura janë të bazuara në urdhrin e ministrit numër 856, më datë 30/5/2012 mbi funksionimin e Orkestrës Frymore të FA. Kjo orkestër ka si mision zhvillimin e të gjitha veprimtarive ceremoniale shtetërore, ushtarake, kulturore e artistike të organizuara nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i FARSH dhe protokollit i shtetit bazuar në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë dhe ceremonialit ushtarak. OFFA është e vetmja trupë unike profesioniste në Shqipëri që mbulon hapësirën ceremoniale zyrtare me këtë renditje: Ceremoniali zyrtar për të gjitha pritjet protokollare shtetërore: President, kryetar i Parlamentit, kryeministër, ministër i Mbrojtjes, ministër i Jashtëm, ministër i Brendshëm, ministër i Kulturës, etj; Ceremonialin zyrtar të FA: Shefi i



cionesh nëpër botë (SHBA, Belgjikë, Itali, Slloveni), funerale; Mbulime aktivitetesh të tjera: Aktivitete për dreka e darka zyrtare të të gjitha personaliteteve të larta, aktivitete të pritjeve dhe koktejeve të ndryshëm nga këto personalitete; Kalendar artistik: OFFA si trupë e vetme profesioniste në Shqipëri kontribuon në jetën artistike të kryeqytetit dhe qyteteve të tjera me koncerte të ndërthurura me program të larmishëm. Për vetë specifikën e saj, kjo orkestër jep koncerte nëpër sheshe dhe ambiente të hapura për një publik të gjerë, po ashtu dhe nëpër salla të mbyllura. Përsa i përket detyrave, janë ruajtur dhe zhvillohen gjithnjë e më mirë vlerat e krijimtarisë muzikore kombëtare, për të gjithë efektivat e FA të Republikës së Shqipërisë, normalisht dhe atyre të huaj, pra këtu hyjnë dhe pjesa e ambasadave, hyjnë dhe prezantimet që Orkestra Frymore bën jashtë institucionit të saj dhe simotrat e saj në vendet e Europës, të NATO-s dhe kudo nëpër botë. Ne kryejmë shumëllojshmëri interpretimesh muzikore duke filluar nga stili barok, klasik deri tek ai modern me show, big-band, me të gjitha llojet e rrymave muzikore.





Formacioni i parë zyrtar i Bandës Shqiptare u krijua gjatë viteve 1912-1915. Gjatë viteve 1928-1939, në vendin tonë krahas bandave muzikore të shoqërive të ndryshme patriotike-kulturore, si "Vatra", "Afërdita", etj., u formua dhe formacioni i parë profesionist-artistik dhe u quajt Banda e Gardës Kombëtare dhe më pas Banda Mbretërore. Orkestra Frymore e Ushtrisë u krijua në tetor të vitit 1944 në fshatin Priskë pranë kryeqytetit (Tiranë) dhe kishte si personel artistik rreth 25 instrumentistë, muzikantë partizanë si dhe ish-pjesëtarë të bandave të krijuara gjatë viteve 1928-1939. Debutimi i parë

## Historiku i OFFA

i Orkestrës Frymore të Ushtrisë u zhvillua më datë 28 nëntor 1944 në Tiranë. Orkestra Frymore Kombëtare e Forcave të Armatosura, e cila mban këtë emër që nga viti 2013 është e vetmja trupë profesioniste në Shqipëri që realizon këto detyra: Protokollin e Shtetit (Presidencë, Kryeministri, Ministri e Mbrojtjes, Shtab i Përgjithshëm si dhe pret e përcjell homologët e tyre); Ceremonitë

Kombëtare (Festa, manifestime, etj.); Ceremoni e Forcave të Armatosura (Përvjetorë, Parada, Inaugurime, etj.); Veprimtari të ndryshme koncertore në vend e jashtë tij.

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura për përkushtimin profesional dhe atdhetar është dekoruar nga presidenti i Republikës së Shqipërisë me titullin "Mjeshtër i Madh i Punës" me urdhrin "Naim Frashëri i Artë". Orkestra Frymore Kombëtare e Forcave të Armatosura ka në përbërjen e saj së bashku me drejtimin 79 punonjës, të gjithë të shkolluar si brenda ashtu dhe jashtë vendit.



Normalisht, ne kryejmë bashkëpunime dhe me formacione të tjera dhe marrim prej tyre më të mirën e mundshme dhe kur flas për formacione nuk flas vetëm për bandat, por dhe bashkëpunimet me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, me Radiotelevizionin Shqiptar, bashkëpunimin me fanfarat e tjera, siç është fanfara e Kosovës, ajo e Shkodrës dhe fanfarat e rretheve të tjera, të cilat kërkojnë ndihmë dhe ne ja sigurojmë atë duke kryer një bashkëpunim mjaft të mirë, siç ishte rasti i vjetshëm i koncertit madhështor që u zhvillua në Shkodër, ku ishin 6 dirigjentë dhe 2 trupa, trupa jonë e shtetit shqiptar, e cila është profesioniste dhe unike dhe trupa e Orkestrës Frymore të Bashkisë së Shkodrës. Vazhdimisht gjatë veprimtarive që shfaqim, zbatojmë standardet më të larta në fushën e krijimtarisë dhe interpretimit muzikor me këto artistë që kemi sot për sot dhe që mbi 95% kanë studiuar në Akademinë e Arteve ose me Universitetin Artesh. Madje ne kemi dhe instrumentistë të ardhur nga jashtë, të cilët janë pjesë e OFFA. Normalisht, nuk mund të lemë pa përmendur që Orkestra Frymore ka një bashkëpunim jashtëzakonisht të

madh përse i përket anës kulturore, siç është Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe ky bashkëpunim kaq i ngushtë vjen dhe nga strukturat me Ministrinë e Mbrojtjes dhe nga Shtabi i Përgjithshëm.

**Po në lidhje me zhanrin ose reper-torin që ndjek kjo orkestër?**

Orkestra frymore duke qenë e plotë dhe duke pasur tashmë në gjirin e saj një organizim dhe funksionim mjaft të mirë, arrin që të mbyllë të gjitha zhanret kulturore-artistike në Shqipëri duke filluar nga formacionet e vogla që

vendosen në aktivitetet që zhvillohen në darkat e zyrtarëve të lartë, të Shtabit të Përgjithshëm, të gjeneralëve të forcave, të ministrave të ndryshëm e deri tek ceremonialët shtetërorë. Pra, kemi kuartete, kuintete, sekstete harqesh, kuintet fryme, sekstet saksash, big-band. Siç e përmenda dhe pak më lart, zhanret fillojnë nga stili barok, klasik e deri tek ai modern dhe të gjitha rrymat europiane të kohës që shqiptarët sot i kërkojnë, meqë jemi pjesë e Europës e po ecim drejt saj. Ka diçka të veçantë që lidhet me këtë vit, sepse viti 2014 është pak simbol për shtetin shqiptar. Këtë vit festojmë 70-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë dhe jemi fokusuar në përthithjen e krijimtarisë për marshe dhe pjesë shqiptare, marshe ushtarake, marshe me këngë partizane meqë 70-vjetori i Çlirimit është një koncert jubilar dhe mendoj se në të gjitha qytetet kryesore do të zhvillojmë veprimtari të ndryshme, përveç asaj që do të zhvillohet më 28-29 nëntor. Gjithashtu, këtë vit kemi dhe 5-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe hyrja në NATO presupozon një lehtësim, pavarësisht se ajo është një strukturë civilo-ushtarake, por në pjesën ushtarake Ministria e Mbrojtjes ka vëmendjen e veçantë të zhvillojë një koncert të madh për Forcat tona të Armatosura të cilat marrin pjesë në misionet, në mënyrë që të bëhet sa më e larmishme jeta kulturore-artistike dhe në repartet ushtarake dhe vazhdimisht ne japim kontributin tonë.

**Cila është përbërja dhe struktura**

**e OFFA dhe në ç' bazë urdhri operon kjo orkestër?**

Orkestra e madhe simfonike frymore ndahet në: Dy formacione ceremoniale (sipas vendit dhe rëndësisë), sekstet harqesh (gjashtë instrumentistë harqesh), grupi i folkut, big-band, kuartet dhe kuintete të ndryshme (4-5 formacione, me 5-6 instrumentistë).

OFFA përbëhet nga 79 veta personel, nga të cilët: drejtim dhe mbështetje 10 punonjës; Instrumentistë fryme 54 punonjës; Perkusion 6 punonjës; Harqe 6 punonjës; Kitarë 2 punonjës; Piano 1 punonjës. Nga këto, 6 janë civilë, 73 ushtarakë (2 oficerë, 1 krye-kapter, 24 kapterë, 14 rreshterë, 5 tatarë, 9 nën-tatarë dhe 19 ushtarë profesionistë). 95% e artistëve janë të diplomuar brenda e jashtë vendit. Këshilli Artistik vendos për të gjithë jetën artistike dhe për mënyrën e organizimit të punës në këtë institucion. Ky këshill, i cili është në funksionim të Orkestrës Frymore dhe është përzgjedhur në mënyrë demokratike, përbëhet nga instrumentistë mjaft të zotë, 6 prej të cilëve janë pedagogë në Akademinë e Arteve, përbëhet nga udhëheqësi Artistik i OFFA, z. Arben Muça; dirigjent nënkolonel, z. Halim Teqja, mjaft i njohur sot në tregun e artistëve, një dirigjent mjaft i talentuar dhe i përkushtuar në punën e tij; flikorno sopran, Gerard Hysa, klarinetë; Petrika Backa që është dhe zëvendës palë i orkestrës; trombë, Ilir Vorpis mjaft i njohur në rrethet artistike; specialist arti, Valmir Xoxa; klarinetë, Mirel Burgija, spala e orkestrës, i cili ka

një performancë të shkëlqyer, një instrumentist high class mund të them. E gjithë kjo është pjesa menaxhuese e orkestrës, look-u i saj. Gjithashtu, Këshilli Artistik bashkëpunon në mënyrë mjaft frytdhënëse dhe me komandantin e OFFA, nëntogerin, z. Altin Babameto, i cili është pjesa përcjellëse e letrave, dokumentacionit, rregullave, siç është e parashikuar në funksionimin e Orkestrës Frymore së Forcave të Armatosura.

Orkestra Frymore e FA operon në bazë të urdhrin të ministrit, i cili është i detajuar për punën dhe funksionimin e Orkestrës Frymore të FA.

**Pas pjesëmarrjes dhe performancës së OFFA në emisionin "Top Show Magazine", në Top Channel, drejtuar nga Alban Dudushi, morët mjaft duartrokitje nga publiku. Mund të më flisni rreth kësaj performancë të sapo konkluduar?**

Kjo ishte një iniciativë e jona në bashkëpunim me Top Channel, ku kërkonim të largoheshim sadopak nga sallat e mbyllura dhe t'i jepnim një imazh Orkestrës Frymore në paraqitje, në disiplinimin që ka kjo orkestër, por dhe nga ana kulturore-artistike, sepse ajo nuk i mungon Orkestrës Frymore, por një paraqitje, një look ndryshe vlerësohet mjaft dhe nga ana e instrumentistëve, të cilët e ndjejnë veten mirë si dhe nga ana e publikut, të cilët interesohen të mësojnë rreth kësaj Orkestre Frymore. Por si ishte detajuar pjesëmarrja në këtë Orkestër Frymore? Ne ishim detajuar në atë mënyrë që edhe të paraqitnim disiplinën, madhësinë e Orkestrës Frymore me veshjet e Grand Uniformës dhe këtu dua të ndalem. Uniforma nuk është veshje ushtarake, ajo është veshje e cilësuar për FA, është një Grand Uniformë, e cila nuk ka sipër grada. Kemi Grand Uniformën Qendrore, e cila është kuq e zi, me të cilën bëhet ceremoniali zyrtar. Më pas, kemi dy Grand Uniforma të tjera, atë blu, që quhet blu koncertore dhe atë të bardhë koncertore dhe me këto veshje ne luajmë në ambiente e salla të mbyllura. Këto uniforma janë mjaft dinjitoze dhe kanë ornamentet e tyre artistike. Brenda asaj 1 ore e 30 minuta që na u besua nga Top Channel, emisioni transmetohej live dhe duke parë cilësinë e instrumentistëve tanë, ne realizuam siglën e hapjes e të mbylljes, e cila u bë po nga orkestrantët tanë dhe një sigël hyrjeje me rreth 10 masa ishte pjesë e prezantimit gjatë kohës që zoti Dudushi bënte prezantimin e personaliteteve. Gjatë gjithë shfaqjes, e cila pati shumë prurje, pjesa më serioze dhe më e bukur për mendimin tonë ishte ajo e paraqitjes së Orkestrës Frymore me veprat e saj mjaft të bukura e të përshtatura për ambientin dhe sytë e publikut si dhe paneli i OFFA. Aty orkestra luajti pjesë klasike, u vendos gjithashtu dhe një serenatë në kujtim të së ndjerës, znj. Vaçe Zela, ku u luajt Shupert nga një saksofonist i joni, pati dhe big-band show deri në xhaz, domethënë të gjitha veprat ishin të rreshtuara në atë mënyrë që ka gjithmonë arti, ngritjen e vet, kulmin e vet që arrihet në pjesën e mesit dhe në fund të aktivitetit. Dirigjent ishte nënkolonel Halim Teqja dhe komandanti i orkestrës, i cili mori përsipër të dirigjonte. Ishte një punë voluminoze e këtyre dy artistëve. Dua të theksoj që në çdo veprimtari që ne kryejmë, për shembull në rastin e Top Channel, morëm përgëzime për performancën që kreu Orkestra Frymore dhe klikimet më të shumta të këtyre emisionit ishin pikërisht për këtë performancë, sepse shumë njerëz nuk e njohin funksionimin, organizimin që kjo orkestër ka dhe në këtë mënyrë u njohën dhe me veprat e saj.






# Ndërveprimi, thelbi i suksesit të FA për mbrojtjen dhe sigurinë kolektive

N/KOL (R) KANAN HIMAJ

Në botën e sotme rindërtimi dhe ri konsolidimi i vendeve bëhet me vështirësi, sidomos vendet me demokraci të brishtë, ekonomi të dobët që shpesh herë shkojnë në tronditje të thellë të stabilitetit. Shpëtimi i tyre, jo rrallë shihet tek ndërveprimi dhe bashkëjetesa me organizmat që prodhojnë siguri për çështjet themelore në politikë, ekonomi, diplomaci, ushtri etj. Nisur sa më lartë, vendet e vogla që kanë më shumë nevojë për mbështetje të tillë dhe ndërveprimi është i domosdoshëm për këto organizma. Në këto kushte, zhvillimi i sigurisë rajonale ka konfirmuar se veprimi i suksesshëm është rezultat i ndërveprimit, brenda një kornize institucionale. Më shumë vlerë në këtë kohë kanë burimet e mbrojtjes, të cilat janë të kufizuara, pra koncepti "smart defence" dhe si e tillë kërkon nxitjen e programeve të përbashkëta për ndërtimin edhe të kontributeve të përbashkëta në forca, pajisje, burime të dobishme për klimën e sigurisë. Tashmë dihet se siguria kombëtare e vendit tonë shihet përmes integritetit në sistemin e sigurisë kolektive, në lidhjen midis sigurisë së brendshme me atë ndërkombëtare. Periudha disa vjeçare e veprimtarisë tonë dhe ndryshimet doktrinarë dhe konceptuale na kanë bindur se veprimet kolektive përcaktohen si veprime të kryera nga Forcat e Armatosura, që i përkasin dy apo më shumë shteteve, brenda një aleancë ose koalicioni, nën patronazhin e një autoriteti ndërkombëtar (OKB-së, OSBE-së, NATO-s, BE-së), me qëllim të përbashkët për mbrojtjen dhe sigurinë kolektive sipas (neni 5 - Traktatit të Uashingtonit ose ESDP- European Security and Defence Policy), për të parandaluar një krizë apo konflikt. Përvoja jonë në kuadër janë stërvitjet e përbashkëta, me pjesëmarrjen e strukturave që i përkasin dy apo edhe më shumë vende, në bazë të planeve të përcaktuara për ndërveprimin në lidhje me strukturën, veprimet, procedurat dhe pajisjet etj. Nga pikëpamja teknike, operacionet e aleancës janë operacione të kombinuara, në gjuhën e terminologjisë ushtarake, termi i ndërveprimit është përdorur shpesh si një sinonim për operacionet shumëkombëshe. Në veprimtarinë tonë, koalicioni është përcaktuar si një marrëveshje ad-hoc në mes të dy ose më shumë kombe në mënyrë që të kryejë një veprim të përbashkët. Veprimi i aleancave në një koalicion kryhet përtej marrëdhënieve të veçanta, për situata të veçanta ose për një bashkëpunim të qëndrueshme, në një fushë të caktuar, e cila është përcaktuar në mënyrë rigorozë për interes të përbashkët. Si rregull, koalicioni është ndërveprim, që nënkupton dakordësinë për një qëllim të përbashkët. Forcat tona të Armatosura si pjesë e aleancës së NATO-s, përgjegjësitë tona nuk janë të kufizuara vetëm për politikën e mbrojtjes kombëtare, por ato përfshijnë veprimet përtej interesave të vendit në mbështetjen e stabilitetit rajonal dhe më gjerë, në mënyrë për të zgjidhur problematikat që ndikojnë interesat e bashkësisë ndërkombëtare. Pjesëmarrja e forcave tona në trajnime dhe stërvitje të përbashkëta me strukturat euro-atlantike nënkupton ndërveprimin dhe përshtatjen e doktrinave, procedurave, pajisjeve, standardet dhe kërkesat e tyre. Planet e perspektivës të FA janë të rrisin pjesëmarrjen në stërvitje të përbashkëta, sidomos me vendet anëtare të NATO-s, duke synuar trajnimin e forcave në dispozicion për NATO-n. Kërkesa për rishikimin e mbrojtjes është transformimi i strukturave



organizative me qëllim përshtatjen dhe adaptimin e strukturave në vartësi të evoluimit të vazhdueshëm të konceptit strategjik të NATO-s dhe në përputhje me ndryshimin e mjedisit të sigurisë. Si përfitim i implementimit të një strukture organizative funksionale mund të konsiderohen eliminimi i njësisë të panevojshme, përmirësimi i vazhdueshëm i zinxhirit të Komandimit dhe Kontrollit, etj. Aplikimi i saj është domosdoshmëri dhe buron nga nevojat për të aplikuar standarde të larta, të orientuara, të krahasueshme me standardet më të mira që aplikohen nga vendet e NATO-s. Në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, ndërveprimi është një element thelbësor për suksesin e operacioneve ushtarake pasi ai lidhet me mbrojtjen kolektive. Në mjedisin e aleancës, ndërveprimi ka fituar një rëndësi të madhe për krijimin e kontributeve të përbashkëta. Tregues janë pjesëmarrja e Forcave të Armatosura në misionet paqeruajtëse dhe luftarake në Afganistan, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë dhe SEEBRIG, etj. Pjesëmarrja në operacionin ISAF ka një peshë të madhe si një kontribut i vendit tonë, me Trupa Speciale dhe Ekipet Trajnuese (OMLT, Shëndetësore dhe Trajnues të FS), të cilat vlerësohen maksimalisht nga strukturat vendimmarrëse të NATO-s (DSACEUR) dhe Komanda e operacionit ISAF. Brenda këtij treguesi qëndron dhe thelbi i ndërveprimit të forcave tona si përbërëse përkatesisht: Kabul (në bashkëpunim me palën turke); Kabul (në kuadër të A-3); Herat (në bashkëpunim me palën italiane); Kandahar (në bashkëpunim me palën amerikane); Kabul (ekipi OMLT). Po kështu, brenda koalicionit në operacionin "Liria e Irakut", forcat tona u bashkuan me vendet aleate dhe partnere duke angazhuar kontingjentin e parë paqeruajtës. Me tej, jo pak i rëndësishëm ka qenë angazhimi ynë me tre kontingjente, në operacionin MINURCAT, të drejtuar nga Bashkimi Evropian, në Çad, Afrikë si pjesë e marrëveshjes dypalëshe midis Republikës së Francës dhe Republikës së Shqipërisë. Apo edhe angazhimi hershëm i vendit tonë, këshilltarë/vëzhgues ushtarakë në operacionin UNOMIG të drejtuar nga OKB, në Gjeorgji. Në vazhdim mund të përmendim si rezultat domethënëse është pjesëmarrja jonë brenda operacionit Althea (Bosnjë - Hercegovinë), nën autoritetin e Bashkimit Evropian si dhe pjesëmarrja e vendit tonë në nisat rajonale SEEBRIG. Nuk ka qenë e lehtë për të arritur nivelin e kërkuar të ndërveprimit me ushtritë e tjera në përbërje të Aleancës apo aleancave me vendet e tjera. Në përbërjen e tyre ka gjithnjë karaktere, kulturë dhe njerëz të ndryshëm, me tradita të ndryshme që vijnë nga pjesë të ndryshme të botës dhe bashkëpunojnë për realizimin e misioneve të tyre në mjedisë shumë të ndryshëm dhe të veçanta. Ekziston një diversitet i madh i forcave të ofruara nga 28 vendet anëtare të NATO-s dhe nga partnerët e tyre. Këto forca veprojnë dhe bashkëveprojnë gjatë misioneve ose ushtrimeve ushtarake në teatrot e ndryshme të operacioneve, larg territorit të Aleancës. Fakti ka treguar se ato janë realizuar kryesisht duke arritur një shkallë të caktuar të ndërveprimit dhe më pas është rritur një aftësi e caktuar ushtarake që ka lejuar trupat të përmbushin të njëjtin mision dhe të kenë të njëjtat objektiva, si në Afganistan, Irak, Bosnjë Hercegovinë, Çad, etj. Nga analiza e nivelit të shkallës së gatishmërisë Forcat tona të Armatosura janë vlerësuar në vijimësi metodën për progresin në përmasimin e sistemit të mbrojtjes dhe përshtatja me sistemin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, ku janë dy elementë të rëndësishëm: së pari, ndërveprimi nga poshtë - lart, fillon me raportimet e kërkesave të ndërveprimit ose mangësitë e vërejtura, "mësimet e nxjerra" nga fushatat e operacioneve ose stërvitjeve të kryera. Procesi projektohet ose është përqendruar në çështjet e propozimeve mbi përcaktimin e mangësive të identifikuar. Qasja e dytë i referohet ndërveprimit "top-down", e kërkuar nga Autoritetet Ushtarake të NATO-s për të identifikuar dhe përcaktuar kërkesat ndërveprimit ushtarak, si pjesë e procesit të planifikimit, për Objektivat e Forcës (FG), dhe duke përcaktuar Paketën e Kapaciteteve (PK). Duke marrë parasysh nivelet e ndërveprimit, ne pohojmë nivelin e ndërveprimit të Forcave Armatosura për realizimin objektivave dhe angazhimeve para NATO-s. Rruga e vendit tonë, si vend aleat në organizatën më të madhe të sigurisë rajonale dhe globale ka nxjerrë në evidencë detyrimet dhe kërkesat në aspektin e mbrojtjes dhe vlerësimin e tyre brenda sistemit të integruar të NATO-s. Një kërkesë e rëndësishme e dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes është zbatimi i konceptit të Kapaciteteve Operacionale të NATO-s. Zbatimi i saj mundëson rritjen e aftësive të strukturave të FA dhe lidhet me zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve operacionale, bazuar në standardet dhe eksperiencat më

të mira të ofruara nga vendet anëtare të koalicionit, sidomos në spektrin e gjerë të përvojës së NATO-s. Gjithashtu, zbatimi i Kërkesave Operacionale ka bërë të mundur unifikimin e procedurave elementeve të reformave të mbrojtjes si për fushat kryesore të arsimimit, personelit, logjistikës, trajnimeve, vlerësimeve, etj. Nga zbatimi i tyre është rritur përvoja jonë në drejtim të informimit dhe analizës. Kështu rezultati është i përafërt me realitetin duke bërë të mundur unifikimin e procedurave të zhvillimit të kapaciteteve në të gjitha llojet e strukturave. Në këtë kuadër mund të përmendim: vlerat e përbashkëta që lidhen me zbatimin e misionit, sipas (Neni 5 dhe Neni jo - 5), doktrinat e partnerit dhe procedurat e njohjes; procedurat e planifikimit dhe taktika, gjuhën dhe terminologjinë ushtarake; marrëdhënieve ndërlidhëse, sistemet e komunikimit dhe shkëmbimit të informacioneve, identifikim, kodifikim, certifikim, sigurim të cilësisë, mbështetje logjistike, teknikat dhe procedurat, trajnimin dhe ushtrimet fizike, të kontrollit dhe procedurat, bashkëpunimin civil-ushtarak, etj. Forcat e Armatosura janë të njohur me të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me ndërveprim, për shkak të sistemit të planifikimit të mbrojtjes të njësuar me NATO-n, unifikimi në tërësi i dokumenteve, doktrinat dhe procedurat ka krijuar hapësirën e duhur për marrëveshjen të qartë dhe ndërvepruese reale me aleatët. Mendojmë se përvoja ka treguar se integrimi në strukturat euroatlantike kërkon një angazhim më të koncentruar në harmonizimin e aftësive tona të forcës për të arritur përputhshmërinë. Arritjen e qëllimeve të ndërveprimit të plotë si pajtueshmëria, standardizimi dhe ngjashmëria kërkojnë vëmendjen tonë të veçantë në trajnimin e forcës dhe në programet e modernizimit. Në nuk mund të arrijmë ato, nëse nuk kërkojmë ndryshimin e proceseve që sjellin transformimin me tendencë për integrimin sa më të plotë në NATO dhe për zgjidhjen me sukses të sfidave me të cilat përballemi sot. Tashmë, koha është të ndërtojmë struktura të lehta në veprimtari dhe të pajtueshme me NATO-n. Nëse nuk ka ndërveprim brenda intelektualizimit të mbrojtjes tonë nuk mund të ketë atë jashtë kufijve të saj dhe nuk mund të thuhet se ne jemi ndërveprues me vendet aleate, kur ai mungon brenda nesh. Sipas angazhimeve tona në NATO, ne kemi zgjedhur një grup objektivash të forcave. Në këtë kuadër

është e rëndësishme të përqendrojmë përpjekjet tona për të arritur detyrat e shtëpisë të vendosura nga strukturat e NATO-s, në funksion të afirmimit të strukturave në përputhje me kriteret e ndërveprimit dhe aftësive ushtarake të shprehur në dokumente zyrtare të NATO-s. Ndërveprimi dhe aftësitë ushtarake janë dy pjesë të ndërvarura. Brenda një aleancë, aftësia e të luftuarit humbet rëndësinë e tij në qoftë se ajo nuk është në nivel të caktuar ndërveprimit. Për të arritur ato, ka disa fusha që kërkojnë përpjekje të veçanta, sidomos kur sot shtrohet për rishikim procesi i ristrukturimit, si: komandë dhe kontrolli, mbështetja logjistike dhe lëvizje strategjike, doktrina, trajnimin vlerësimi dhe certifikimi, teknologjia dhe sistemet e armatimeve, procesi i vendimmarrjes etj. Fakti se trupat shqiptare janë të pranishme në mjedisin ushtarak ndërkombëtar është një tregues i rëndësishëm që lidhet me zhvillimin e procesit të ndërveprimit brenda FA. Mësimet e nxjerra nga teatrot e operacioneve është shumë i rëndësishëm për ndërveprimin. Ato duhet të zbatohen në programet e trajnimit të njësisë dhe reparteve, sidomos të atyre që veprojnë jashtë vendit. Një nga sfidat më të mëdha është ndryshimi doktrinarë moderne, fillimi i një sistemi modern të trajnimit në përputhje me standardet dhe kërkesat e misionit. Procesi i ndërveprimit është shumë kompleks, ai nuk mund të jetë i fiksuar në një kornizë, ka dinamik dhe veçori nga periudha në periudhë, por edhe i ndryshëm me vendet që bashkëpunon. Si i tillë kërkon përshtatjen e bashkëpunimit në interesin e zhvillimit të detyrave, përmirësimin të sistemit të mbrojtjes, rritjes së shpejtësisë në transformimin e forcave dhe përfitim i përvojës më të mirë nga vendet aleate të NATO-s. Brenda këtij kuadri për ne do të jetë e rëndësishme njësimi i standardeve dhe të pajtueshmërisë me funksionet dhe detyrat. Ndërveprimi i Forcave tona të Armatosura në të gjithë spektrin e misioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së do të vijojë për pjesëmarrjen në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s dhe /ose zonë të BE-së, sipas nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit, pasi ky është kuptimi i ndërveprimit aktiv për luftën kundër terrorizmit, mbrojtjen e kombëtare dhe atë kolektive. Gjithashtu, ndërveprimi për zbatimin e misioneve do të ndërtohet në përputhje me procesin e transformimit të Aleancës dhe Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Procesi kërkon kapacitete për të vepruar në raste emergjence; mbështetjen e autoriteteve civile, kur ajo lidhet me fatkeqësitë natyrore, njerëzore, kimike apo biologjike, etj. Forcat e Armatosura të përgatiten të përballojnë situata fill-estare, deri në mbërritjen e forcave kryesore të reagimit në zonën e operacionit të përbashkët, me ose pa - Host Nation Support; sigurimi linjat e komunikimit dhe pikat strategjike. Niveli i ambicies së Shqipërisë në NATO është balanca ndërmjet detyrimeve për kontribute ushtarake dhe joushtarake në kuadër të Aleancës, qëllimeve politike dhe ambicies për prezencë të vendit tonë, si dhe e kapaciteteve që disponojmë për të realizuar këto ambicie. Është me rëndësi të veçantë të sigurohet mbajtja e drejtëpeshimit midis deklaratimeve politike për përcaktimin e nivelit të synimit kombëtar për forcat në dispozicion të Aleancës dhe mbështetjes së tyre me burimet e nevojshme financiare e njerëzore për të qenë në një zgjidhje sa me efikasitet të ekuacionit me dy të panjohura detyrimeve dhe përfitimeve.



# Në Bazën Ajrore Farkë, atje ku jeta gjallon mes tokës dhe ajrit

KAPITENE FLORINKA ALLA

**B**aza Ajrore Farkë është një strukturë e rëndësishme e Forcës Ajrore, ku kryhen me përkushtim dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara që rrjedhin nga misioni i kësaj Baze, por edhe misioni i Forcës Ajrore. Personeli i kësaj Baze është përpjekur me gjithë mundësitë për të realizuar në kohë dhe më së miri misionin e saj. Viti 2014 si objektivi kryesor të punës së personelit të kësaj Baze ka rritjen e shkallës së gatishmërisë operacionale për realizimin e misionit, për përbalimin e emergjencave civile, vazhdimi i trajnimit të personelit pilot dhe teknik, si dhe zhvillimi i programit të kalimit të pilotëve të rinj nga një tip helikopteri në tjetrin. Me anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në NATO, prioritetet dhe objektivat e Bazës Ajrore Farkë janë orientuar drejt përbushjes së standardeve të fluturimit, përgatitja e personelit për të qenë i aftë për të punuar me të njëjtat standarde si vendet e NATO-s, si dhe bashkëpunimi dhe realizimi i stërvitjeve të përbashkëta, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës në fushën ushtarake. Fillimviti 2014, për pilotët e Bazës Ajrore përkon edhe me fillimin e programit të stërvitjes ajrore e cila ka si objektivi kryesor arritjen e standardeve të kërkuara nga NATO për pjesëmarrjen në misione ajrore, duke synuar kualifikimin e efektivave për të realizuar detyrat në një nivel më të lartë, kalimin e pilotëve nga një tip helikopteri në tjetrin dhe përgatitja e instruktorëve të rinj. Flota ajrore është modernizuar me helikopterë COUGAR dhe kryesisht të funksioneve të kërkim-shpëtimit (SAR), transport të sëmurësh/të plagosurish, si dhe Transport Trupash, të cilët janë një investim dhe angazhim për përbushjen detyrimeve dhe standardeve që dalin nga anëtarësimi i vendit tonë në NATO. Procesi i modernizimit në teknikë po ecën paralelisht edhe me procesin e trajnimit të pilotëve dhe teknikëve që do të përdorin këtë tip helikopteri. Me futjen në operim të kësaj teknike Forca Ajrore synon rritjen e kapaciteteve operacionale për të qenë e aftë për zhvillimin e operacioneve në kondita të ndryshme të motit. Falë marrëveshjes së nënshkruar midis Ministrisë sonë të Mbrojtjes me qeverinë Franceze dhe kompaninë "Eurocopter", si dhe me kompaninë "FB Heliservice" në Mbretërinë e Bashkuar, është realizuar si dhe vazhdon trajnimi i pilotëve dhe teknikëve që do të shfrytëzojnë këtë teknikë. Në Forcat e Armatosura Franceze është realizuar trajnimi i pilotëve në simulator, pranë kompanisë "Eurocopter" po në Francë u trajnuan pilotët dhe teknikët për përdorimin e helikopterit COUGAR. Në kompaninë "FB Heliservice" në Mbretërinë e Bashkuar është në proces trajnimi i gjithsej 12 pilotëve për helikopterët shumërolësh, nga të cilët 4 pilotët si dhe 2 aerospëtuesve dhe 2 do të përfundojnë programin e fluturimit për shërbimin SAR. Krahas përfundimit të programit të trajnimit në këto vende, trajnimi i pilotëve ka vazhduar në Bazën Ajrore Farkë. Tashmë grupi prej 4 pilotësh në helikopterit COUGAR po stërviten me instruktorin francez, për



një stad më të lartë të aftësive të tyre fluturoese. Major Eduard Koçi, kapiten Çlirim Plaku, kapiten Ervin Buzi dhe kapiten Klajdi Tushe përfunduan fazën e trajnimit për zhvillimin e fluturimeve vetëm ditën dhe në kushte të thjeshta meteorologjike/ VFR dhe tashmë janë certifikuar si komandantë ekuipazhi. Trajnimi i mëtejshëm i tyre do të vazhdojë me rritjen e aftësive fluturoese në llojet e misioneve operacionale, taktike, në kondita të vështira meteorologjike dhe natën në këtë tip helikopteri. Ky grup pilotësh është trajnuar më parë në kompaninë "Eurocopter" në Francë për Type Rating, në Forcat e Armatosura Franceze në simulator dhe më pas ka vijuar në Mbretërinë e Bashkuar për përdorimin e helikopterëve shumërolësh. Nëpërmjet zhvillimit të këtyre trajnimeve pilotët me anë të fluturimeve reale në kondita të ndryshme meteorologjike në helikopter dymotorësh, aftësohen

dhe rritin shkallën e profesionalizmit, për të operuar me të njëjtat standarde dhe procedura fluturimi si vendet e NATO-s. Këto trajnime përfshijnë zhvillimin e programeve teorike dhe praktike për përgatitjen bazë të pilotëve, përgatitjen e avancuar, njohjen e tyre me teknikën e fluturimit ushtarak, me fluturimin operacional të helikopterit dymotorësh, fluturimin instrumental, si dhe përgatitjen e ekuipazheve të shërbimit SAR. Trajnimi dhe përgatitja e grupit të pilotëve për helikopterit shumërolësh COUGAR për Forcat Ajrore, do të sigurojë garantimin e operacionalitetit të kërkuar, si dhe të gatishmërisë ajrore për realizimin e detyrave që rrjedhin nga misioni i Forcës Ajrore. Me anë të realizimit të këtyre trajnimeve si në shkollat perëndimore, ashtu edhe në Bazën Ajrore Farkë, Forca Ajrore Shqiptare krijon grupin e pilotëve plotësisht të ndërveprueshëm

dhe të integrueshëm në operacionet e NATO-s, si dhe siguron vazhdimësinë e përgatitjes së pilotëve të tjerë në këto nivele brenda vendit. Përveç këtij grupi kalimi, në Bazën Ajrore Farkë ka filluar edhe programi i trajnimit për pilotët të cilët kalojnë nga një tip helikopteri në tjetrin. Ndër më të rinjtë që ka filluar fluturimet këto ditë në këtë Bazë është piloti nëntoger Donald Hoxha, i cili i ka përfunduar studimet në Itali. Fillimisht fluturimet për Donaldin kanë filluar në helikopterit trenerues AB-206 për të vijuar më tej në tipet e tjera të helikopterëve. Komandanti i Bazës Ajrore Farkë evidenton dhe vlerëson punën e mirë që bëhet nga efektivit fluturoes në drejtim të zbatimit të rregullave të fluturimit si dhe implementimit të STANAG-ve të përcaktuara për stërvitjen ajrore. Në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara midis Ministrisë sonë të Mbrojtjes me Forcat e Armatosura Franceze ashtu edhe me Mbretërinë e Bashkuar për modernizimin në teknikë dhe trajnimit të pilotëve, komandant Lama shprehet se gjatë vitit 2014 përparësi në kryerjen e orëve të fluturimit do të kenë pilotët e rinj dhe pilotët në funksion të fluturimeve me helikopterit COUGAR dhe EC-145. Po ashtu do të planizohen programe të veçanta stërvitje me ekuipazhet prioritare (pilotët e rinj, ekuipazhet e helikopterëve COUGAR dhe EC-145) për përmirësimin e aftësive fluturoese të pilotëve në misione stërvitore me helikopterë të vetmuar, në formacion, fluturim IFR, stërvitjet dhe operacionet "JOINT", "SAR" në tokë dhe në det, si dhe stërvitjet ajrore me vendet aleate.

## Mirëmbajtja e teknikës ajrore

Stërvitja Ajrore dhe realizimi sa me sukses i saj nuk mund të kuptohet pa mirëmbajtjen e helikopterëve. Në Bazën Ajrore Farkë, krahas përdorimit të teknikës ajrore për kryerjen e misioneve dhe stërvitjes ajrore, rëndësi i kushtohet mirëmbajtjes dhe sigurimit

të gatishmërisë së teknikës për operim. Për realizimin sa më mirë të misionit nga efektivit i mirëmbajtjes së teknikës ajrore kërkohet rritje e nivelit tekniko-profesional, me synim kryerjen e plotë të punimeve të mirëmbajtjes së nivelit "Flight Line +", ndjekja e kurseve -On Job Training- si dhe vazhdimi i trajnimit institucional pranë kompanisë "Eurocopter" dhe enteve të tjera të certifikuar në sinkron kjo me trajnimin e efektivit fluturoes. Trajnimi, aftësimi profesional dhe përkushtimi kanë bërë që vazhdimisht Forca Ajrore, kur është paraqitur nevoja ka qenë e gatshme për të operuar, veçanërisht në rastet e emergjencave të ndryshme.

## Qendra e situatës ajrore

Aktiviteti stërvitor nuk do të mund të realizohej pa bashkëpunimin dhe koordinimin e punës me Qendrën e Situatës Ajrore në Bazën Ajrore Farkë. Çdo fluturim apo operacion ajror menaxhohet më së miri nga kontrollorët e kësaj qendre, duke ndikuar në mbarëvajtjen e programit stërvitor. Janë gjithsej 10 kontrollorë ajrore që zhvillojnë shërbim gatishmërie lindje-perëndim dielli, dhe në planet afatshkurtra synohet futja në operacionalitet të plotë dhe mbajtja në gatishmëri 24/7 e kësaj qendre. Kjo qendër ka si mision të saj mbështetjen me asistencë në lidhje me trafikun ajror gjatë kohës së shërbimit, me qëllim harmonizimin dhe sigurimin e mjeteve fluturoese të Bazës Ajrore Farkë, apo edhe të bazave të tjera. Komunikimi në këtë qendër kryhet sipas STANAG-eve të përcaktuara, si dhe manualeve të ICAO për komunikimin dhe menaxhimin e trafikut ajror. Me ndryshimet e reja të bëra në ristrukturimin e Bazës Ajrore Farkë, është shtuar edhe dëshira e femrave për të punuar pranë kësaj strukture. Ajo që të bie në sy në këtë qendër është edhe prania nëntogere Lisjana Mitre, e cila është kontrollorja e parë femër që menaxhon trafikun ajror gjatë ditëve të zakonata të stërvitjes ajrore.

## Në BrMR fillon kursi i gjuhës angleze, niveli i parë

**N**ë datën 10.01.2014 në Brigadën e Mbështetjes Rajonale filloi kursi i gjuhës angleze niveli i parë me 18 ushtarakë kryesisht nënoficerë dhe ushtarë profesionistë nga 2 kompaninë prioritare dhe kompaninë mbështetëse së përgjithshme dhe kompania e kërkim shpëtimit. Kursi i gjuhës angleze niveli i parë në njësi është organizuar dhe funksionon që nga viti 2007. Të gjitha pajisjet e laboratorit me kapacitet njëzetedy vende dhe literatura përkatëse janë dhuratë e palës amerikane. Që nga ajo kohë në njësi është organizuar dhe funksionon normalisht kursi i mësimi të gjuhës angleze në nivelin e parë, vetëm me personel nënoficer, ushtarë profesionist të njësisë, me qëllim rritjen e numrit të personelit anglisht folës, por edhe kualifikimit të tyre të mëtejshëm në këtë drejtim. Në këtë angazhim sa serioz aq edhe profesional, edhe qendra e Gjuhëve të Huaja e FA ka dhënë ndihmesën e vet, në radhë të parë me pajisjen me literaturën përkatëse, librat nga 1-24,



por edhe me instruktorë dhe me testimet përkatëse. Vite më parë, në mbështetje të këtij kursi në njësi, nga British Council (Këshilli Britanik) janë dhuruar edhe materiale audio dhe filmike, si dhe literaturë përkatëse, të cilat kanë përmirësuar më tej nivelin didaktik të mësimdhënies dhe kanë lehtësuar arritjen e standardeve të përcaktuara. Në kursin e nivelit të parë të gjuhës angleze prioritet i është dhënë nënoficerëve dhe ushtarëve profesionist, të cilët janë kontingjent i strukturave të OF (Objektiveve të Forcës) pa neglizhuar personelin edhe strukturat e tjera vartëse. Si rezultat

i kësaj pune serioze dhe tërësisht profesionale, gjatë periudhës 2007-2013, kanë zhvilluar kurse 9 grupe mësimore me mbi pesëmbëdhjetë vetë në grup. Në përfundim të kurseve dhe të testimeve të monitoruar nga QGJH të FA, është bërë certifikimi i këtij personeli, sipas testimit ALCPT dhe STANAG - 6001, të përcaktuara nga NATO. Aktualisht, si instruktorë të gjuhës angleze në këtë kurs janë aktivizuar kapiten Orgest Baholli, togere Viola Hoxha dhe rreshtere Irena Qordja. Personel të njësisë, të cilët, pa lënë mënjanë detyrat funksionale, bëjnë edhe rolin e instruktorit. Për të arritur në nivelin e instruktorit të gjuhës angleze, kapitenit Orgest Baholli i është dashur shumë punë: ka ndjekur dhe përfunduar individualisht kursin e Oksfordit në Tiranë, trajnimet ushtarake për instruktor në programin DLIELE, në San Antonio, Teksas, të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-së. Histori të ngjashme kanë edhe Viola Hoxha dhe Irena Qordja; ato kanë punuar fort, fillimisht në mënyrë individuale në kurse të ndryshme, pastaj duke ndjekur kurse

në QGJH të FA-së, për të arritur në këtë nivel të admirueshëm. Programet mësimore të kursit janë mbështetur dhe njësuar me programin mësimor të QGJH të FA. Në vazhdimësi, kursi është pajisur me literaturë bashkëkohore të dhuruar nga pala amerikane, e cila është futur në përdorim nga personeli mësimdhënës dhe pjesëmarrës. Edhe personeli mësimdhënës, në mënyrë periodike, është trajnuar dhe kualifikuar në seminare të ndryshme, të kryer nga QGJH të FA dhe nga pala amerikane. Këto aktivitete kanë ndikuar në rritjen e nivelit të mësimdhënies të instruktorëve por edhe në përvetësimin e programit nga personeli pjesëmarrës. Në hapjen e kursit Komandanti i BrMR, gjeneralbrigade Muhamet Buçpapa duke uruar personelin pjesëmarrës vuri theksin për rëndësinë që ka për çdo ushtarak njohja e gjuhës angleze. Në përfundim të kursit aktual instruktorët shpresojnë të arrijnë një rezultat të kënaqshëm me të gjithë personelin pjesëmarrës.



# Vizioni i presidentit Obama për arsimin, ekonominë, politikat sociale dhe FA

“State of the union”, fjalimi i përvitshëm i fillim-vitit të presidentit të SHBA-së

Nga: Agron Loci

“State of the union”, i shqipëruar si fjalimi i përvitshëm i fillim vitit të presidentit amerikan edhe këtë vit ngjalli kureshtjen dhe interesin e shumë politikanëve por edhe përfaqësuesve të biznesit, të shoqërisë civile dhe të organizmave të tjera ndërkombëtare. Në fjalën e tij përpara kongresit presidenti Obama, pasi bëri një përmbledhje të arritjeve në fushën e ekonomisë, të sipërmarrjes, të edukimit, të politikave sociale e deri tek forcat e armatosura e diplomacia u kërkoi ligjvënësve amerikanë që të mbështesin disa nga reformat e ndërmarra nga ai dhe administrata e tij në interes të të gjithë shtetasve amerikanë. Viti i veprimit e konsideroi ai 2014 dhe në përmbushjen e këtij angazhimi ai kërkoi që puna të fokusohet në disa aspekte kryesore ku për ekonominë qëllimi kryesor duhet të jetë forcimi i pavarësisë së ekonomisë amerikane nga importet kryesisht ato të energjisë përmes rritjes dhe përmirësimit të prodhimit vendas. Reforma në sistemin arsimor, në atë shëndetësor, në sistemin zgjedhor por edhe në sistemin aktual fiskal, marrëdhëniet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve, raportet mes institucioneve shtetërore dhe biznesit ishin disa çështje të tjera ku u kërkua konsensus dhe vendosmëri në çuarjen përpara të tyre. Në fjalën e tij presidenti Obama u ndal edhe në aktualitetin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura. Ai shprehu vendosmërinë për tërheqjen e trupave amerikane nga misioni i ISAF duke filluar nga fillimi i vitit të ardhshëm dhe dislokimi në Afganistan i një kontingjenti të vogël trupash amerikane të cilët në bashkëpunim me një numër trupash nga vendet aleate do të merren me trajnimin dhe mbështetjen e forcave ushtarake-policore afgane në përpjekjet e tyre për të luftuar terrorizmin dhe vendosjen e shtetit ligjor. Një vend të veçantë në fjalimin e tij zë edhe raportet mes Forcave të Armatosura dhe Diplomacisë, një qasje e re kjo që pavarësisht ndryshimeve në perceptim mes këtyre dy institucioneve në fund të fundit qëllimi i tyre mbetet i njëjtë, garantimi i paqes dhe sigurisë për shtetasit amerikanë, për aleatët dhe vendet ku ata ushtrojnë funksionet e tyre.

\*\*\*

Në fjalimin e tij të pestë si President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, fjalim i përvitshëm i fillim vitit i cili njihet si “State of the Union”, apo siç është njohur më parë deri në vitin 1934, si mesazhi i përvitshëm i kreut të shtetit, Presidenti Barack Obama u fokusua tek një numër i madh çështjesh kryesisht të politikës së brendshme por edhe të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Thelbi i fjalimit të këtij viti ishte i sintetizuar në mesazhin se të gjithë aktorët politikë qofshin këta përfaqësues të



ekzekutivit apo të legjislativit duhet që të garantojnë sigurinë dhe prosperitetin për shtetasit dhe biznesin amerikan. Mesazhi është i qartë dhe në ndryshim nga koncepti tradicional metafizik i sigurisë që lidhej kryesisht me aspektin e mbrojtjes ushtarake dhe atë të shërbimeve inteligjente, koncepti modern i sigurisë përfshin në vetvete shumë elementë, ai është një koncept tejet dinamik dhe mund të realizohet me sukses vetëm nëse të gjitha pjesët funksionojnë në harmoni si dhe arrijnë të njohin dhe të përshtaten sa më shpejt me ndryshimet e kushtëzuara nga fenomeni i globalizmit. Ashtu si çdo vit fjalimi i presidentit pritej me shumë interes jo vetëm në SHBA por edhe në shumë vende të tjera pasi në të evidentohen dhe theksohen më qartë nga njëra anë arritjet dhe nga ana tjetër edhe linjat kryesore të angazhimit politik në të ardhmen, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm jo vetëm për zhvillimet brenda vendit por edhe në marrëdhëniet me aleatët dhe partnerët e ndryshëm. Fjalën e tij presidenti amerikan e filloi me një rezymë mbi ecurinë e ekonomisë amerikane të cilën e vlerësoi si pozitive pasi gjatë 2013 ajo kish dhënë shenja të qarta të kapërcimit të krizës ekonomike financiare. Sipas tij, SHBA kanë aktualisht nivelin më të ulët të papunësisë në pesë vitet e fundit, sektori i sipërmarrjes ia ka dalë të rimarrë veten dhe për pasojë ka gjeneruar më shumë vende të reja pune, amerikanët prodhojnë aktualisht më shumë naftë dhe gaz natyror, dhe kjo ndodh për herë të parë pas njëzet viteve, ndërkohë që ka një përgjysmim të deficitit. Gjithashtu vlerësohet fakti se SHBA pas më shumë se një dekadë ja kanë arritur të bëhen vendi me nivelin më të lartë të investimeve të huaja në botë duke lënë pas Kinën pas shumë vite dominimi në këtë aspekt. Duke ju referuar angazhimeve për 2014 kërkohet konsensusi i të gjitha forcave politike për ta konsideruar këtë vit si viti i veprimit. Sipas tij miratimi i një qëndrimi dhe përcaktimi të tillë për vitin

që sapo ka nisur mbështetet tek bindja e palëkundur që ai vetë por edhe amerikanët pa asnjë dallim kanë tek domosdoshmëria e implementimit në praktikë të konceptit të garantimit të mundësive të barabarta për të gjithë. Sipas presidentit është detyrë e politikës që këtë nocion ta materializojë në praktikë. Domosdoshmëria e kësaj qasje të re, mbështetet tek ndikimi që realitetet e reja të dominuara nga dukuria e globalizmit kanë pasur në ekonominë e individëve, të sipërmarrjeve të vogla, të mesme e deri tek korporatat multinacionale gjatë tre dekadave të fundit. Statistikat flasin qartë se diferencat në të ardhurat janë thelluar aq shumë sa që janë krijuar gap-e të konsiderueshme në akumulimin e kapitaleve financiare por edhe njerëzore. Ajo që bie në sy është fakti se megjithëse fitimet e korporatave kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit, kjo tendencë rritje e të ardhurave të tyre nuk ka ecur me të njëjtin ritëm edhe për sa i përket rritjes së të ardhurave të punëmarrësve amerikanë. Ndaj në fjalën e tij përveç apelit që ju drejton drejtuesve të kompanive për të vlerësuar mundësinë e rritjes së të ardhurave të punonjësve të tyre presidenti u bëri thirrje njëkohësisht edhe kongresmenëve dhe ligjvënësve amerikanë që të miratojnë një ligj në të cilin të përcaktohet niveli minimal i pagës për një orë pune, masë kjo e detyruar të zbatohet nga ana e të gjithë punëdhënësve amerikanë. Mbështetja me politika dhe nisma konkrete ekonomike dhe fiskale e klasës së mesme vazhdon të mbetet shqetësimi dhe një ndër angazhimet kryesore të presidentit pasi ajo konsiderohet si motori lëvizës i shoqërisë amerikane, si shtresa që sjell numrin më të madh të vendeve të punës por njëkohësisht edhe të ardhurat më të mëdha në buxhetin e shtetit. Rëndësia e garantimit dhe e konsolidimit të pavarësisë energjetike zuri një vend shumë të spikatur në fjalën e presidentit. Dhe në këtë pikë ai i referohet burimeve të tilla si nafta, gazi natyror e deri tek energjia solare. Biznesi, korporatat

amerikane por edhe konsumatori e qytetari amerikan duhet të furnizohen me energji që sigurohet nga burimet vendase ndërkohë që niveli i importeve për sigurimin e saj duhet të vijë duke u ulur. SHBA janë një vend i pasur me burime naftë dhe gazi por edhe me burime të konsiderueshme që garantojnë prodhimin e energjisë diellore. Nafta si burim kryesor që vë në lëvizje motorin e ekonomisë por edhe nënproduktet e saj të gjitha këto “Made in USA” duhet të sigurohen nga burimet vendase, po ashtu siç është e mundur edhe furnizimi me gaz natyror gama e përdorimit të të cilit duhet të vijë duke u zgjeruar në mënyrë që të zëvendësohen burimet energjetike që ndotin mjedisin. Një mesazh ky i mirëpritur nga ana e ambientalistëve amerikanë me gjithë skepticizmin e tyre për sa kohë që SHBA vazhdojnë të mbeten ndotësi kryesor në botë për shkak të nivelit të lartë të emetimeve të dyoksidit të karbonit që shkarkohen në atmosferë nga industria amerikane. Parashikimet janë që edhe për 2014 administrata Obama do të vazhdojë të jetë në opionencë me pjesën më të madhe të grupeve të interesit dhe shoqatat mjedisore. Nëse mbështetja tek burimet energjetike vendase nga njëra anë do të zvogëlojë varësinë e SHBA nga furnizimi nga jashtë nga ana tjetër stimulimi dhe shfrytëzimi me efikasitet i burimeve vendase si dhe rritja e volumit të nxjerrjes, përpunimit dhe shfrytëzimit të tyre do të rrisë numrin e vendeve të punës për shtetasit amerikanë. Qeverisja është arti i propozimit të alternativave dhe projekteve konkrete të cilat sado të vogla që të duken në fillim kur ato implementohen me sukses dhe seriozitet bartin me vete rezultate konkrete të prekshme dhe që mund të kenë ndikime shumë dimensionale. Iniciativa të tilla siç janë ato të partneritetit mes shkollës, biznesit dhe përfaqësuesve lokalë kanë bërë që të ulen niveli i obezitetit ndër të rinjtë fakt që ky që përkthehet në përmirësimin e cilësisë së jetës por edhe me uljen e kostos për përkujdesjen



“Koncepti modern i sigurisë përfshin në vetvete shumë elementë, ai është një koncept tejet dinamik dhe mund të realizohet me sukses vetëm nëse të gjitha pjesët funksionojnë në harmoni si dhe arrijnë të njohin dhe të përshtaten sa më shpejt me ndryshimet e kushtëzuara nga fenomeni i globalizmit”.

shëndetësore. Po kështu iniciativa të tjera si promovimi i mundësive të individëve si përpjekje e përbashkët mes universiteteve, bizneseve dhe shoqatave jo fitim prurës kanë rezultuar të frytshme pasi kanë shpënë në uljen e nivelit të pabarazisë lidhur me aksesin që duhet të gëzojë çdo individ për edukimin e lartë. Në kushtet e konkurrencës globale ku kompanitë e mëdha por edhe të mesme amerikane shpesh janë të detyruara të transferojnë kapitalet si dhe know-how e tyre jashtë vendit për shkak të kostos më të lirë të fuqisë punëtore por edhe të klimës së biznesit dhe ligjeve më të përshtatshme tatimore dhe taksative, presidenti bëri thirrje për të amenduar legjislacionin në mënyrë që biznesi amerikan të fillojë të rikthejë biznesin e tyre në SHBA. Sipas tij ka ardhur koha të rishikojmë legjislacionin në lidhje me taksat me synimin final që t’i ulim ato dhe ta bëjmë sërish Amerikën një vend tërheqës jo vetëm për biznesin vendas por edhe atë të huaj. Një pretendim dhe angazhim shumë i vështirë por që duket se presidenti është më tepër sesa i vendosur për të ndërrhyrë në amendimin e legjislacionit mbi taksat dhe politikat fiskale. Sigurisht që në këtë realitet ku përpjekjet për të siguruar investime e tregje janë të konsiderueshme edhe vendet e tjera do të vazhdojnë të përpjekin që të krijojnë mjedise interesante për zhvillimin e promovimin e biznesit si dhe të ofrojnë incitative fiskale përfshi këtu dhe kapacitete njerëzore që të konkurrojnë SHBA. Në këtë kontekst global është e rëndësishme që SHBA të jenë të qarta dhe të evidentojnë sektorët ku të vazhdojnë të ruajnë dhe të konsolidojnë rolin e liderit global. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar sektorit të zhvillimit të programeve dhe sistemeve të reja në fushën e teknologjisë informatike. Edhe në këtë fushë ka një strategji të përcaktuar e cila mbështetet në bashkëpunimin ndërmjet bizneseve të kësaj fushe me departamentet kërkimore shkencore të universiteteve amerikane, bashkëveprim ky që në vija të përgjithshme garanton faktin që SHBA të vazhdojnë të jenë në rolin e liderit global në fushën e teknologjisë informatike. Sipas presidentit është i njohur fakti se ai komb që sot investon në fushën kërkimore ai do të jetë në gjendje që të zotërojë ekonominë globale nesër. Nuk mund të mbetet jashtë vëmendjes edhe çështja që lidhet me emigracionin e paligjshëm në SHBA. 11 milionë njerëz të ardhur nga vende të ndryshme të botës për një jetë më të mirë në SHBA dhe që nuk zotërojnë dokumentacionin e duhur duhet të legalizohen në mënyrë që puna, kontributi dhe përkushtimi i tyre të njihet nga shteti por edhe që ata të kenë mundësi të ndjejnë veten si njerëz të lirë të një vendi që qysh në fillimet e tij ka pasur dhe ka në themelet respektimin e parimit të lirisë për cilindo individ pavarësisht nga prejardhja, raca apo gjendja shoqërore...  
(Vijon në numrin tjetër)



# SHMU, domosdoshmëri kombëtare me standarde ndërkombëtare

*Flet nënkolonel Bardhyl Imeraj, komandant i Shërbimit Meteorologjik Ushtarak*

Në intervistën e mëposhtme, nënkolonel Bardhyl Imeraj, komandant i Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, flet mbi disa çështje kryesore që kanë lidhje me SHMU siç janë prioritetet e vitit 2014, përmirësimi i infrastrukturës, puna me materialet e arkivit të SHMU-së, përgatitjen profesionale, emergjencat civile etj.

**Zoti komandant, cilat janë disa nga arritjet e Shërbimit Meteorologjik për vitin 2013?**

Synimi kryesor i punës sonë për periudhën që kaluam ka qenë konsolidimi performancës së këtij Shërbimi për të qenë i ndërveprueshëm e në funksion të aktiviteteve operacionale të Forcave të Armatosura dhe pjesë e vendimmarrjes së tyre dhe Autoriteteve Civile të vendit. Në këtë drejtim në mënyrë të dukshme ka një rritje të ndërveprueshmërisë në veçanti në rastet e emergjencave civile, ku Shërbimi Meteorologjik ka realizuar tërësisht detyrat në përbushje të misionit për mbështetjen me informacion meteorologjik të të gjithë aktiviteteve të strukturave ushtarake e civile të vendit. Harta e shpërndarjes së rrjetit të Stacioneve të SHMU, sipas kodit të vendndodhjes, me gjerësi, gjatësi e nivel deti të njohur nga OBM duke plotësuar kushtet e vendosura në Rregulloren Teknike Nr. 6 të kësaj organizate, kryerja e matjeve të elementeve meteorologjike si dhe raportimi i tyre në kohë reale, kanë realizuar një mbulim të plotë në monitorimin e masave ajrore në qarkullim duke plotësuar kështu nevojat për informacion gjatë aktivitetit të fluturimeve si dhe në interes të komunitetit. Shërbimi Meteorologjik Ushtarak gjatë vitit që shkoi ka qenë një strukturë e rëndësishme dhe e gjithë përfshirë duke mbështetur me informacion të saktë meteorologjik çdo operacion e vendimmarrje deri në stabilizimin e situatës meteorologjike. Këto situata jo vetëm që kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e një Shërbimi Meteorologjik dhe më të fuqishëm në funksion të aktivitetit njerëzor, por kanë evidentuar vlerat reale që ka ky Shërbim siç janë profesionalizmi, shkalla e lartë e operacionalitetit, bashkërendimi të punës si dhe ndjenja e përgjegjësisë e çdo specialisti të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak. Rritja e aftësive të ndërveprueshmërisë në të gjithë sektorët si në atë operacional, të parashikimit të motit e në stacionet e rrjetit e vrojtimit të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak ka qenë dhe mbetet një nga objektivat kryesorë për ne. Bashkërendimi i punës së këtyre sektorëve, ka çuar në rritjen e cilësisë së produktit meteorologjik duke bërë atë një produkt me efektshmërinë e kërkuar në çdo aktivitet ku kushtet e motit kanë ndikimin e tyre si në kosto ashtu dhe në cilësinë e realizimit të misioneve apo operacioneve të kryera.

**Puna e personelit të SHMU ka specifika të veçanta, si është punuar për përgatitjen profesionale të tyre?**

Po kjo është e vërtetë, prandaj në qendër të vëmendjes së punës sonë ka qenë dhe mbetet ruajtja dhe rritja e nivelit të lartë të përgatitjes profesionale të personelit. Për këtë janë organizuar kurse trajnuese për personelin e ri, me programe të rifreskuara sipas normativave të përcaktuara nga ICAO dhe OBM. Në përputhje me strukturën dhe TOP e SHMU është synuar rritja e gatishmërisë në të gjithë rrjetin e Shërbimit Meteorologjik për mbështetjen me informacion meteorologjik në çdo kohë dhe në çdo situatë duke realizuar kështu misionin



dhe detyrat e përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Meteorologjik.

Programet e përgatitura sipas standardeve e në mënyrë të vazhdueshme janë kryer kurse, mësimet treguese dhe programe specifike me të gjithë personelin. Përveç kësaj në mënyrë të vazhdueshme në stacione dhe në Komandën e SHMU janë zhvilluar trajnime në punë (on job training) në situata të rënduara meteorologjike bazuar në procesin dhe konceptet e "Mësimeve të Nxjerra". Në këtë kuadër në Komandën e SHMU është zhvilluar kursi për vrojtues meteorolog me personelin e emëruar rishtaz në Shërbimin Meteorologjik. Kursi u zhvillua sipas programit me tema të standardeve që aplikohen në shkollat e certifikuar nga OBM. Në përfundimin e programit mësimor kursantët (9 punonjës) i janë nënshtruar testimit me njohuritë e marra dhe kanë rezultuar me rezultate mjaft të mira. Me personelin janë kryer kurse individuale sipas programeve të azhurnuara nga instruktorët e përcaktuar për këtë qëllim dhe njëkohësisht kanë kryer praktikën pranë stacioneve ku janë emëruar siç është rasti i punonjësve të emëruar në stacionin Durrës, Vlorë dhe Tiranë. Tashmë i gjithë personeli i Stacioneve është i trajnuar në përdorimin sipas rregullores teknike Met S-1 të regjistrimit të të dhënave meteorologjike në vrojtimet Synop dhe sipas normativave ICAO për vrojtimet Metar.

**Çfarë pune po realizohet me materialet e arkivit të SHMU?**

Nga personeli që punon në zyrën e analizimit të të dhënave meteorologjike është bërë një punë mjaft e mirë. Deri tani ka përfunduar dixhitalizimin e të dhënave meteorologjike të matura në rrjetin e Stacioneve të SHMU për periudhën 2006-2010. Duke marrë në konsideratë që për periudhën 5-vjeçare për një stacion meteorologjik janë hedhur nga ditaret SYNOP, në kompjuter afërsisht 2.900000 të dhëna (vlera të elementeve meteorologjik).

Nga të dhënat e dixhitalizuara janë përpunuar dhe është përgatitur statistika për elementet kryesore meteorologjike me tabela dhe grafikët përkatës për Stacionet Kukës, Peshkopi, Shkodër, Gjadër dhe Tiranë.

**Cilat janë disa nga synimet kryesore të SHMU për vitin 2014?**

Synimet kryesore të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, për vitin 2014 janë disa, ku ndër më kryesoret do të veçoja: Konsolidimin e strukturës aktuale të Shërbimit Meteorologjik, përgatitjen profesionale dhe rritjen e operacionalitetit me

shërbimeve teknike të nivelit të parë për instrumentet dhe pajisjet në përdorim me qëllim saktësinë e kontrolluar të matjeve në çdo kohë. Në rritjen e aftësive për përgatitjen në kohë nga salla operacionale e paketave të transmetimit të të dhënave për të gjithë rrjetin e stacioneve me qëllim pasqyrimin e të dhënave në hartat rajonale të modeleve matematikore. Gjatë këtij viti, rëndësi do të kushtojmë përgatitjes profesionale të personelit të ri në Shërbimin Meteorologjik nëpërmjet aplikimit të sistemit standard të trajnimit dhe me aplikimin e programeve trajnuese dhe stërvitore individuale dhe kolektive në të gjitha nivelet dhe sektorët veç e veç dhe të ndërthurura në procesin e analizimit të situatave meteorologjike dhe dhënien e produktit të prognozave meteorologjike.

**Cilat janë disa nga prioritetet e punës suaj për përmirësimet në infrastrukturën e Stacioneve meteorologjike?**

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak dhe në këtë drejtim ka specifikë të veçantë. Ai është i përhapur gati në të gjithë territorin e vendit tonë që nga Barjam Curri e deri në Sarandë. Për përmirësimin e infrastrukturës do të punohet në dy drejtime kryesore: Së pari për krijimin e kushteve normale të punës nëpërmjet Degës Logjistike F. Ajrore në 2 stacionet e reja sipas planit të përhapjes në Barjam Curri dhe Sarandë; dhe së dyti në investime për rinovimin të dy stacioneve në ndërtesave ekzistuese të mbetura pa u rikonstruuar duke i sjellë ato në kushte normale pune. Në këtë drejtim po punohet intensivisht për zhvendosjen e stacionit të Gjadrit në ambiente më të përshtatshme. Realizimi i këtyre punimeve do të kontribuojë direkt në përmirësimin e nivelit të gatishmërisë për t'u përgjigjur nevojave të veprimtarisë së FA dhe atyre të komunitetit. Unë kam bindjen se me ritme më të shpejta do të ecet në këto prioritetet, ashtu dhe për azhurnimet e reja, duke patur përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që na jep komandanti i Forcës Ajrore gjeneralbrigade Frederik Beltoja.

**Si veprohet nga strukturat e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak në rast të Emergjencave Civile.**

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat shtetërore që veprojnë në rastet e emergjencave civile. Komanda e Shërbimit Meteorologjik ka plan të veçantë veprimi për rastet e emergjencave. Zbatimit me korrektesë i planit të veprimeve për rastet e situatave të rënduara meteorologjike nga secili sektor i Qendrës Meteorologjike dhe stacioneve për realizimin e detyrave në zbatim të Ligjit për Shërbimin Meteorologjik Ushtarak si dhe nga mësimet e nxjerra në situatat meteorologjike të rënduara që ka kaluar vendi ynë në vitet e kaluara, përbën një garanci për realizimin me sukses të detyrave në këtë drejtim. Në situata të rënduara meteorologjike në të gjithë rrjetin e Shërbimit Meteorologjik përforcohet dhe intensifikohet puna për ndjekjen e vazhdueshme të situatës meteorologjike dhe prodhimin e informacionit mbi gjendjen dhe parashikimin e motit në mënyrë të detajuar duke plotësuar nevojat me këtë informacion të Forcave të Armatosura po ashtu edhe për Pushtetin Lokal në Shtabet e emergjencave në Qarqe, Ministrinë e Bujqësisë, KESH, etj. Informacioni i dhënë nga ana e Shërbimit Meteorologjik ka shërbyer mjaft mirë dhe ka ndihmuar për marrjen e masave të duhura për situatën e krijuar sidomos në

lidhje me fluturimet e kryera. Këto situata të vështira meteorologjike, nuk nxjerrin në pah vetëm profesionalizmin e Shërbimit Meteorologjik por edhe shkallën e lartë të sakrificës ku nuk mund të lihen pa përmendur personeli i stacionit Kukës siç janë z. Mustafa Kaculi, rreshter Dritan Cenaj, të cilët me gjithë kushtet e vështira të punës kanë arritur që të realizojë në kohë e më së miri detyrat. Gjithashtu në situata të rënduara meteorologjike punë të palodhur ka bërë personeli i Stacionit Elbasan i drejtuar nga z. Jordan Vako, Stacioni Peshkopi drejtuar nga Znj. Festime Elezi, stacionit Krocë nga z. Gezim Mecja, Stacioni Gjirokastër nga Tetar Orges Çako etj, të cilët me shumë nga të tjerët për vetë kushtet e krijuara në këto rajone kanë qenë në gatishmëri në çdo kohë duke dhënë informacion të vazhdueshëm gjatë gjithë aktivitetit të fluturimeve si dhe në komisionet e emergjencave.

**Në çfarë niveli është bashkëpunimi me organizmat dhe institucionet homologe vendase dhe të huaja?**

Këto ditë zhvilloi një vizitë pune në SHMU, një delegacion me përfaqësues të lartë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë (World Meteorological Organization) me qëllim evidentimin e standardeve dhe progresin që kemi bërë në fushën e meteorologjisë si dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm. Ne i njohim të pranishmit mbi historikun e shërbimit, gjendjen, rajonet e vendosjes së stacioneve meteorologjike, ecurinë, hapat dhe punën për ndryshimin e mentalitetit duke arritur standardet e përcaktuara nga OBM e ICAO, arritjet në realizimin e detyrave dhe misionit në interes të nevojave të Forcave të Armatosura dhe në kuadër të Emergjencave Civile. Si një arritje u theksua puna për përgatitjen profesionale e punonjësve duke bërë të mundur certifikimin 100% të personelit që punon në këtë Shërbim. Gjatë bashkëbisedimit përfaqësuesi i OBM z. Dimitri Ivanov, shprehu konsideratat e larta për punën, performancën dhe arritjet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak. Ky Shërbim-tha zoti Ivanov- ka arritur standarde të larta dhe është në të njëjtin nivel me shërbimet simotra në Rajon. Falë punës e këtyre standardeve, tashmë të dhënat meteorologjike janë pjesë e sistemit global të transmetimit, duke e kthyer atë në një shërbim efikas si në interes të Forcave të Armatosura ashtu dhe në interes të institucioneve kryesore të vendit e të Emergjencave Civile. Përfaqësuesit e lartë të OBM shprehën dëshirën për rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm të OBM me Shërbimin Meteorologjik Ushtarak. Duke vlerësuar gjendjen aktuale si dhe nevojat e SHMU për pajisje e bazë materiale, në kuadër të modernizimit të bashkëpunimit, përfaqësuesit të OBM u shprehën të gatshëm për mbështetjen dhe kompletimin me instrumente dhe pajisje për disa nga stacionet meteorologjike të vendosura në rajone të ndryshme të vendit tonë. Në zbatim të Ligjit përkatës, SHMU do të vijojë bashkëpunimi me institucionet homologe si brenda vendit ashtu dhe ato të huaja, sidomos me palën Italiane dhe OBM, për shkëmbimin e të dhënave meteorologjike, me qëllim avancimin më tej të punës në fushën e meteorologjisë, duke patur në konsideratë azhurnimet që do të përcaktohen nga Parlamenti i OBM.

Intervistoi: Major (r)  
Aleksandër Çala



## Komiteti Ushtarak i NATO-s mirëpret progresin e Gjeorgjisë në reformat e mbrojtjes

Komiteti Ushtarak, autoriteti më i lartë ushtarak i NATO-s, kreu vizitën e tij të parë në Gjeorgji më 11-12 shkurt për të krijuar një përshtypje mbi reformat ambicioze të mbrojtjes së Gjeorgjisë si dhe për të përgëzuar kontributin e saj të rëndësishëm në operacionet e misionet e drejtuara nga NATO. Kreu i delegacionit të NATO-s, gjenerali Knud Bartels, kryetar i Komitetit Ushtarak, përgëzoi progresin e bërë nga Gjeorgjia në transformimin e Forcave të saj të Armatosura dhe theksoi: "Komiteti Ushtarak i NATO-s i mbështet fuqishëm këto reforma dhe pret forcim të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak me Gjeorgjinë në drejtim të angazhimeve operacionale dhe të ndërveprimit, në mënyrë që të zhvillojë partneritetin e dobishëm që është ndërtuar gjatë viteve".

Me ftesë së Ministrisë së Mbrojtjes të Gjeorgjisë, përfaqësuesit ushtarakë të 28 vendeve anëtare të NATO-s, mbajtën takimim e parë të Komitetit Ushtarak me Gjeorgjinë, në kryeqytetin e saj Tbilis

për të diskutuar kontributin e Gjeorgjisë në operacionet e NATO-s dhe progresin e saj në reformat e mbrojtjes. "Fakti që ne sot jemi këtu, është një shenjë e qartë e mbështetjes së NATO-s për përpjekjet e ndërmarrja nga Gjeorgjia", komentoi gjenerali Bartels. Duke nderuar gjeorgjianët e rënë në operacionet e udhëhequra nga NATO, përfaqësuesit e Komitetit Ushtarak shprehën vlerësimin e thellë të NATO-s për kontributin e Gjeorgjisë në sigurinë euroatlantike. "Personeli ushtarak i Gjeorgjisë vazhdon të qëndrojë i gatshëm për të bërë sakrificën e fundit për paqe ndërkohë që përpjket të parandalojë krizën, menaxhimin e konflikteve dhe stabilizimin e situatave të pas konfliktit", tha gjenerali Bartels gjatë ceremonisë të vendosjes së kurorës në Sheshin e Heronjve në Tbilis. Në takimim me presidentin dhe kryeministrin e Gjeorgjisë përpara seancës së Komitetit Ushtarak, gjenerali e përshkroi bashkëpunimin ushtarak ndërmjet NATO-s e Gjeorgjisë si konstruktiv, pragmatik dhe

shembullor, duke theksuar: "Gjeorgjia është kontribuuesja më e madhe në ISAF e vendeve të cilët nuk janë anëtarë të NATO-s. Ajo është zotuar të mbështesë misionin e udhëhequr nga NATO për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane pas vitit 2014 dhe për të marrë pjesë në Forcën e Reagimit të NATO-s në vitin 2015. Ky dinamizëm në drejtim të angazhimeve ushtarake është një demonstrim i rëndësishëm i angazhimit të Gjeorgjisë në NATO dhe ne mezi presim të rrisim bashkëpunimin ushtarak pas vitit 2014". Gjithashtu, kryetari diskutoi progresin e rëndësishëm të Gjeorgjisë në reformat e mbrojtjes me ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm së Forcave të Armatosura gjeorgjiane duke theksuar: "NATO qëndron krah për krah me Gjeorgjinë në rrugën e saj drejt integritit euroatlantik. Ne jemi të angazhuar të ndihmojmë në forcimin e aftësive tuaja mbrojtëse me qëllim krijimin e një Force të Armatosur me një aftësi më të madhe,



moderne e profesionale që është plotësisht e ndërveprueshme me NATO-n". Mbledhja e Komitetit Ushtarak në sesion të përhershëm me Gjeorgjinë ju dha mundësi pjesëmarrësve të shkëmbejnë pikëpamje mbi perspektivat e bashkëpunimit ushtarak NATO-Gjeorgji. Duke kryesuar diskutimet, Knud Bartels ripohoi rëndësinë e kësaj vizite si një shprehje e lidhjeve të thella ushtarake të NATO-s me Gjeorgjinë dhe tha: "Komiteti Ushtarak ne formatin e Gjeorgjisë si dhe Komiteti Ushtarak me Planin e Punës së Gjeorgjisë mbeten mjete shumë të dobishme për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ushtarak". Vizita përfundoi

me një konferencë nga gjenerali Bartels e cila iu adresua studentëve dhe fakultetit të Akademisë së Mbrojtjes Kombëtare Gjeorgjiane me temë: "NATO gati: Mbrojtja dhe Siguria e Aleancës në shekullin XXI". Gjenerali bartjes u impresionua nga niveli i njohurive të studentëve dhe cilësia e lartë e pyetjeve sfiduese të cilat iu bënë. "Kjo tregon se ndoshta nuk është vetëm krijimi i mbrojtjes duke u përmirësuar, por ndoshta më e rëndësishmja transformimi është reflektuar në institucionin më të lartë ushtarak, i cili më bën të sigurt se transformimi është gjithëpërfshirës, i qëndrueshëm dhe i pakthyeshëm".

## Maqedonia në NATO, sapo të gjendet një zgjidhje e pranueshme për çështjen e emrit

*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rasmussen: Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe opozitës dhe në të gjitha komunitetet, mbetet esenciale për të shpërndarë potencialin e plotë të reformave"*

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, priti kryeministrin Nikolla Gruevski në selinë e NATO-s më 12 shkurt për një takim me Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Aleancës dhe Republikës së Maqedonisë. "Ne e vlerësojmë shumë kontributin tuaj të madh në ISAF dhe ndihmën tuaj me linjat e komunikimit për KFOR-in në Kosovë. Ju jeni një kontribuues i fortë për sigurinë ndërkombëtare", tha Rasmussen.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe kryeministri Gruevski diskutuan përparimin në reformat e rëndësishme, duke përfshirë sektorin e mbrojtjes. Rasmussen theksoi se ky do të jetë çelësi për të mbajtur vrullin e reformës. "Struktura efikase demokratike, një dialog gjithëpërfshirës dhe liria e mediave janë të rëndësishme për t'ju ndihmuar të çoni përpara aspiratat tuaja euroatlantike. Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe opozitës dhe në të gjitha komunitetet, mbetet esenciale për të



shpërndarë potencialin e plotë të reformave", tha ai. Sekretari i Përgjithshëm shtoi se Aleanca e mirëpret angazhimin e vendosur të Shkupit në procesin e anëtarësimit në NATO. "Ne kemi rënë dakord t'ju zgjasim ftesën për t'u bashkuar me Aleancën sa më shpejt të arrihet një zgjidhje reciprokisht e

pranueshme për çështjen e emrit. Ne i qëndrojmë angazhimeve tona, kështu ne do të vazhdojmë të punojmë ngushtë me ju për t'ju mbështetur në përpjekjet e reformave thelbësore, në mënyrë që të mund të lëvizim shpejt sapo të zgjidhet çështja e emrit dhe ju inkurajojmë që të vazhdoni përpjekjet tuaja për të gjetur një

zgjidhje", tha ai. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s theksoi se të gjithë aleatët janë dakord se politika e NATO-s e Dyerve të Hapura e ka bërë Europën më të sigurt dhe se anëtarësimi në Aleancë duhet të bazohet tek performanca. "Ka ende punë për të bërë, por dyert tona mbeten të hapura", tha ai.

**Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe ministrja e Jashtme moldave diskutuan intensifikimin e bashkëpunimit**



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, e përgëzoi angazhimin e Moldavisë për të rritur dialogun politik dhe bashkëpunimin praktik me Aleancën në bisedimet me ministrin e Jashtëm të Moldavisë, Natalia Gherman, më 10 shkurt. Rasmussen përgëzoi ministrin në lidhje me iniciativën e fundit të një Marrëveshje Asocimi me Bashkimin Europian në samitin e Vilniusit, e cila tregon se Moldavia është në rrugën e duhur për të arritur objektivat e saj të integritit europian. Ai shprehu vlerësimin e fortë për vendosjen e ardhshme të Moldavisë në misionin e KFOR-it të udhëhequr nga NATO, gjë që dëshmon se Moldavia dëshiron të jetë një garantuese e sigurisë në zonën euroatlantike.

Sekretari i Përgjithshëm i bëri thirrje Moldavisë për të vazhduar programin e saj të reformave në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes dhe përsëriti angazhimin e Aleancës në ndërtimin e marrëdhënieve më të ngushta. Ai përmendi gjithashtu modernizimin e Akademisë Ushtarake të Moldavisë, përpjekjet për të vazhduar për të forcuar transparencën në sektorin e mbrojtjes si dhe shkatërrimin konkret të pesticideve dhe kimikateve të rrezikshme dhe rezultatet e dobishme të bashkëpunimit ndërmjet NATO-s dhe Moldavisë.

Rasmussen bëri të qartë se aleatët e kuptojnë dhe e respektojnë rëndësinë e neutralitetit kushtetues të Moldavisë, duke theksuar se NATO ka marrëdhënie të shkëlqyera me shumë vende neutrale. Ai theksoi se NATO do të vazhdojë të mbështesë pavarësinë e Moldavisë, sovranitetin dhe integritetin territorial.

Alba Musaraj

## Mbërrin në Spanjë e para nga katër anijet e marinës amerikane, e cila mbështet mbrojtjen nga raketat balistike

Epara nga katër anijet luftuese të marinës amerikane, e cila do të formojë një pjesë qendrore të mbrojtjes nga raketat balistike të NATO-s (BMD), mbërriti në portin e saj të ri, në Bazën Detare Spanjolle të Rotës, më 11 shkurt.

USS Donald Cook, një multi-mision i mbrojtjes raketore, e pajisur me një sistem luftarak mbrojtjeje me një teknologji të lartë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në Rota. Ajo do të kryejë mbrojtjen nga raketat, në mesin e shumë detyrave të tjera, nga përfshirë operacionet e sigurisë detare, stërvitjet trajnuese dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe operacionet e NATO-s dhe vendosjen e

trupave, duke përfshirë pjesëmarrjen në grupet e Përhershme Detare të NATO-s. "Për herë të parë, një anije e marinës së Shteteve të Bashkuara e pajisur me sistem të mbrojtjes ndaj raketave balistike, u vendos në mënyrë të përhershme në Europë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. "Mbërritja e USS Donald Cook shënon një hap drejt NATO-s, për sigurinë europiane dhe për bashkëpunimin transatlantik. Tre anije të tjera të së njëjtës klasë do t'i bashkohen USS Donald Cook gjatë dy viteve të ardhshme. USS Donald Cook dhe anijet e saj motra kanë aftësi të avancuara sensorësh dhe interceptorë raketash, të cilat mund të zbulojnë

dhe të hedhin poshtë raketat balistike. Duke pritur këto anije, Spanja po jep një kontribut thelbësor në mbrojtjen raketore të NATO-s, duke rritur sigurinë e Europës, Mesdheut dhe Oqeanit Atlantik duke shkurtuar kohën e përgjigjes për anijet amerikane. Në nëntor të vitit 2010, në samitin e Lisbonës, krerët e shteteve dhe qeverive vendosën që NATO do të zhvillojë një aftësi të mbrojtjes raketore për të mbrojtur të gjithë popullsinë dhe territorin europian të NATO-s. Aftësi e përkohshme e sistemit u deklarua në samitin e NATO-s në Çikago, në vitin 2012. Aftësi e plotë është parashikuar për gjysmën e parë të dekadës së ardhshme.




PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI  
PROF. ASOC. DR. HEKURAN RAPAJ

### Historiografia, debati dhe kuptimshmëria e LANÇ-it

Debatet mbi argumente shkencore dhe gjenerimin e kundërshtive ende nuk janë shuar edhe në kuadër të 70-vjetorit të çlirimit të vendit. Në shtatë dekada janë zhvilluar qindra konferenca, tryeza debate mbi trajtimin historik të periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; janë publikuar me dhjetëra qindra libra, emisione televizive e radioje, janë bërë filma si dhe gjini të tjera të artit e kanë trajtuar gjerësisht tematikën e LANÇ-it. Megjithatë debatet janë ndezur ndonjëherë edhe me ashpërsi pas viteve 90-të. Aspekte që mbeten ende të debatueshme për sa i përket Luftës Nacionalçlirimtare nuk janë vetëm objekt i shkencave historike. Në shkencë asnjë gjë nuk është e prerë përfundimisht, veçanërisht në shkencën historike që e ka në thelbin e vet debatin. Historiografia nuk mund të arrijë synimet nëse të vërtetat nuk konsiderohen relative e të plotësohen gradualisht dhe të bazuara në dokumente. Këtu nevojitet synimi i qartë që të flitet e shkruhet saktësisht e dokumentuar. Tezat nuk mund të ngrihen mbi paragjykimet për të hedhur poshtë dhe as për ta glorifikuar një ngjarje përfshi edhe LANÇ. Edhe në këndvështrimin pas 70 vjetësh LANÇ është një nga fazat nga më të ndritura të historisë tonë kombëtare, që nga rezultatet, pjesëmarrja dhe faktit se, me LANÇ-in u rifitua pavarësia, u rreshtuam me aleatët anglo-ruso-amerikanë, fituam një kapital politik me të cilin përballuam intrigat e të këqijve sidomos fqinjëve dhe mbështetësve të tyre, hodhëm poshtë planin e tyre për copëtimin e Shqipërisë pas lufte, në betejën diplomatike që ishte Konferenca e Paqes e Parisit në vitin 1946. Gjithashtu LANÇ nuk është ish-regjimi dhe me këtë nuk mund të ngatërrohen çështjet dhe nuk mund të zbehen vlerat e luftës, duke theksuar se pas saj erdhi regjimi njëpartiak. Lufta Nacionalçlirimtare ishte një mision historik popullor ku nga shumica e shqiptarëve u kuptua dhe u vlerësua drejtë, por edhe u realizua me sukses të plotë përmes sakrificash të jashtëzakonshme. Zhvillimet pas luftës kanë qenë kontradiktore, me anët pozitive e negative, si çdo proces historik dhe kjo nuk do të thotë se mund të zbehen luftën dhe vlerat e saj. Debatet për Çlirimin e Shqipërisë janë të natyrshme, edhe rreshtimi politik e ndarja ideologjike është gjithashtu e pranueshme sepse sikurse çdo shkencë edhe Historiografia shqiptare nuk mund t'i shpëtojë debatit. Vetëm në diktaturë idetë rrafshohen sepse argumentet dhe kundërshtitë janë krejt normale në demokraci.

### "Respektimi i pavarësisë" së Shqipërisë me "qëndrim ushtarak të përkohshëm"

Kanë kaluar 70 vjet nga betejat e përgjakshme midis partizanëve shqiptarë dhe pushtuesve italianë dhe gjermanë në LIIB. Faktet historike flasin për kapitullimin e Italisë fashiste, me 8 shtator 1943 dhe vendin e saj e zuri gjermania naziste. Njësitë partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare e pritën me armë ushtrinë naziste pavarësisht pabarazisë në forca e mjete, në pajisje dhe armatim. Luftime të ashpra kujtesa historike por edhe ajo dokumentare ka regjistruar në rajonet Xhyrë, tek Ura e Kardhiqit, në Cepo në rrugën Elbasan-Tiranë, në Krujë, në afërsi të Konispolit, në Delvinë, në Sarandë, në rrugën Janinë-Korçë etj. Veçanërisht e ashpër ka qenë përleshja me trupat gjermane në Drashovicë të Vlorës, ku gjermanët u detyruan të tërhiqen, duke lënë në fushëbetejë shumë të vrarë e të plagosur, si dhe sasi të mëdha materiali luftarak. Ndërkohë, trupat naziste të korpuseve XXI e XXII u vendosën në qendrat kryesore të vendit. Për të mashtruar popullin shqiptar, nazistët deklaruan se "do të respektonin pavarësinë"



Harta e veprimtarisë së çetave në Shqipëri sipas gjermanëve

Nat. Gruppen  
Komm. Banden



**Kanë kaluar 70 vjet nga betejat e përgjakshme midis partizanëve shqiptarë dhe pushtuesve italianë dhe gjermanë në LIIB. Faktet historike flasin për kapitullimin e Italisë fashiste, me 8 shtator 1943 dhe vendin e saj e zuri gjermania naziste. Njësitë partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare e pritën me armë ushtrinë naziste pavarësisht pabarazisë në forca e mjete, në pajisje dhe armatim.**

# "Operacioni i Dimrit" në këndvështimin e pas shtatë dekadave

e Shqipërisë dhe se "qëndrimi i trupave të tyre ushtarake ishte i përkohshëm". Por, nga ana tjetër, ata deklararon se "do t'i përgjigjeshin energjikisht çdo sulmi që do të ndërmerrej kundër tyre". Pushtuesit gjermanë krijuan një "Komitet Ekzekutiv të Përgjithshëm", me në krye Ibrahim Biçakun. Më 16 tetor 1943 thirrën në Tiranë një "Asamble Kombëtare", e cila shpalli ndarjen e Shqipërisë nga Italia dhe caktoi "Këshillin e Lartë të Regjencës" (KLR), me në krye Mehdi Frashërin. Më 5 nëntor 1943, Regjencia shqiptare emëroi qeverinë me kryetar Rexhep Mitrovicën. Faktikisht gjithë organizmat ishin organizma të krijuara formalisht dhe artificialisht, pasi pushtetin real e kishin Komanda e Lartë e ushtrisë gjermane dhe përfaqësuesi gjerman për Europen Juglindore Noibaher. Më 18 tetor 1943, artileria e Brigadës III Sulmuese goditi me top pallatin ku zhvillonte punimet "Asamble Kombëtare", e thirrur nga gjermanët. Në këtë situatë luftarake komplekse dhe kur ndarja politike shqiptare ishte thellësisht armiqtësore, gjermanët ndërmarrin një prej aksioneve më masive për të shuar lëvizjen partizane shqiptare. Faktikisht lëvizjet e gjermanëve në teatrin luftarak europian ishin të kushtëzuara nga frontet luftarake të hapura. Gjermanët në këndvështrimin gjeopolitik e gjeohapësinor do të përfitonin për të zbarkuar menjëherë në bregdetin shqiptar, përpara se këtë gjë ta bënin forcat anglo-amerikane. Siç del dhe nga një telegram i ministrit Ribbentrop, qëllimi i zbarkimit të gjermanëve në Shqipëri, ishte dislokimi i tyre në bregdetin shqiptar, kryesisht në zonën përballë Kënalet të Otrantos, për t'ju mbrojtur krahët trupave të tyre që tërhiqeshin nga Greqia në Shqipëri e në drejtim të Jugosllavisë e më tej me destinacion Berlinin, nga ndonjë sulm i mundshëm anglo-amerikan.


### Përgjakje e një populli të tërë në emër të lirisë dhe të së drejtës

Mësymja armike e dimrit 1943-1944 dhe heroizmi popullor. Me qëllim që të shkatërronin Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe të likuidonin Lëvizjen Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, pushtuesit gjermanë ndërmorën një mësymje të përgjithshme ushtarake. Në mësymje, e cila filloj në nëntor 1943, krahas katër divizioneve të ushtrisë naziste morëm pjesë dhe forcat kolaboriste vendase. Në kuadrin e mësymjes së përgjithshme, armiku ndërmori një varg operacionesh në zona të ndryshme të vendit. Ndërsa më 5 nëntor 1943, forcat armike sulmuan krahinën e Pezës, ku ndodhej Brigada III dhe grupi partizan i Pezës, një nga vatrave dhe trevat më të fuqishme antifashiste në Luftën e Dytë Botërore. Luftimet vazhduan 5 ditë. Pasi pësuan humbje të konsiderueshme forcat gjermane e pushtuan Pezën, por forcat partizane mundën ta çanin rrethimin me humbje të vogla, edhe pse masakra ndaj popullsisë së kësaj treve ka qenë e madhe. Më pas operacioni gjerman u drejtua në disa zona si në zonat e Vlorës, të Gjirokastrës, Tepelenës, Përmetit, Skraparit, Korçës, Mallakastër, Berat, në zonën Çermenik-Shengjin-Martanesh, në Malësinë e Gjakovës etj. Njëkohësisht gjermanët zhvilluan operacione ndëshkimore edhe në qytetet kryesore të vendit, si: në Vlorë, në Durrës, në Elbasan, në Shkodër, në Korçë, në Tiranë etj. Me operacione të posaçme armiku mundi të pushtoj qytetet Pogradec, Berat, Peshkopi, Dibër e Madhe, Gjirokastrë etj., të cilët ishin çliruar pas kapitullimit të Italisë fashiste. Kudo trupat armike ndeshen me qëndruesin e partizanëve dhe popullit, të cilët qene të detyruar të përballeshin, në kushte tepër të vështira të dimrit, me një armik disa herë më të madh në numër

e me një epërsi të pa krahasueshme në teknikë luftarake. Në këto kushte, ushtria fashiste u shkatëroi dëmet të mëdha forcave partizane që vepronin në Shqipërinë e mesme dhe të veriut. Megjithatë këto të fundit nuk u asgjësuan. Ato u detyruan të vepronin në formacione të vogla në zonat e pushtuara nga ushtria gjermane. Gjatë mësymjes së operacionit të dimrit armiku përdori terrorin në shkallë të gjerë kundër popullsisë kryesisht në fshatra, por edhe në qytete. Gjermanët plaçkitën pasuritë e fshatarëve, u vinin zjarrin fshatrave të tera, vrisnin burra, gra, pleq e fëmijë. Terrori u shtri dhe në qytetet e pushtuara si në Vlorë, në Durrës, në Shkodër, në Korçë, në Tiranë etj., ku mijëra njerëz të thjeshtë u arrestuan dhe u çuan në kampet e vdekjes. Kështu në Tiranë me 4 shkurt 1944 gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre vranë dhe masakruan 84 veta brenda një nate. Por me gjithë dëmet dhe humbjet që i shkatëroi popullit dhe lëvizjes Nacionalçlirimtare, operacioni i dimrit nuk i arriti objektivat për asgjësimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Brenda shkurtit dhe marsit 1944, njësitë partizane në Shqipërinë e Jugut e rimorën veten dhe madje arritën të merrnin dhe nismën luftarake, duke kaluar nga mbrojtja në kundërmësymje. Brenda një kohe të shkurtër u spastruan gati të gjitha krahinat e shkelura nga gjermanët. Ndërkohë, marshimi i një pjese të Brigadës së I Sulmuese në Çermenik, në Gollobordë, në Mat, në Shëngjin, në Pezë e në zonën e Dumresë e forcoi besimin e popullit dhe ndihmoi në gjallërimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në krahinat veriore të vendit. Në këtë mënyrë, populli dhe Ushtria e tij Nacionalçlirimtare dolën nga kjo provë e vështirë më të fortë e më të fuqishme, të ripërtërirë në të gjitha drejtimet. Pushtuesit të zemëruar egërsisht nga dështimi

i fazës së parë të Operacionit të Dimrit, ndërmorën me ashpërsinë më të madhe disa fazat të këtij operacioni barbar: faza e parë në muajt nëntor dhjetor 1943 si dhe fazën e dytë që zgjati nga 29 janar deri më 6 shkurt 1944; fazën e tretë, e cila u zhvillua në periudhën 6 deri 14 shkurt 1944 dhe fazën e katërt e cila zgjati nga 4-12 prill 1944. Qëllimi final i forcave gjermane ishte asgjësimi i të gjitha vatrave kryengritëse të Luftës Nacionalçlirimtare në zonat e lëvizjes. Nuk përjashtojë këtu edhe rolin e diversionit të brendshëm dhe propaganda armiqtësore që mbillej kudo një taktikë kjo tashmë e njohur për forcat partizane. Në këtë kuadër vetë emërtimet e fazave: "Harridoh" (Thirrja për të çuar gjahun në shteg), "Un dennoch" (dhe megjithatë), "Wolfschlucht" (Gryka e Ujqërve), krahas atij të fazës së parë "Berkessel" (Kazani malor), tregon qartë se nazistët gjermanë "gjahun" e kapur donte ta përvëlonte të gjallë në "kazanin malor". Por ka pasur edhe emërtime të tjera të atij pushtuesi që vinte "si miq të Shqipërisë" dhe "se ishin në kalim e sipër". Operacionet e koduar "505", "1828", "Pik" bënë që të zhvilloheshin operacione të përgjakshme në zonat më nevralgjike të vendit dhe aty ku ishin bazat më të rëndësishme të LANÇ. Ka qenë një gjetje emërtimeve me brendi dhe që synonte "larje hesapësh" përfundimtare me "nacionalçlirimtarët e malit". Në operacionin e Dimrit i shkurt 1944 në Malësinë e Gjakovës u përfshinë edhe mercenarë shqiptarë bashkë me gjermanët, sikurse edhe në operacione të tjera, si në Operacionin e Qershorit 1944 në Bytyç etj, po kështu përpjekje ka pasur edhe në Lumë të Kukësit. Në relacionet e përfaqësuesve të misioneve angleze thuhet se: "Në Jug Balli është kthyer thjesht në milici qeveritare... atyre u ka dalë kaq tepër nami si kolaboracionistë... Shumë kontakte kanë provuar se si bashkëpunon me qeverinë kuislinge... Partizanët vazhdojnë si më parë të jenë e vetmja forcë që lufton kundër gjermanëve". Dhe këto relacione vijjnë pikërisht nga aleatët anglezë që e kishin njohur luftën e shqiptarëve që në vitin 1942. Brigadat Sulmuese ishin në shënjestër të pushtuesit, megjithëse rritja e shpejtë e forcimit të tyre si dhe taktika e shkathët partizane dhe orientimet e shtabit të Përgjithshëm bënë që të triumfohej në të gjitha fazat e operacionit. Por terreni shqiptar kodrinor e malor, rrjeti i kufizuar i komunikimit, veprimet luftarake të rrufeshme të ushtrisë partizane e sidomos në prita, kurthe, sulme natën, aksione në krah, në shpinë e nga pozicione të favorshme bënë të gjitha këto që operacioni i përgjakshëm i dimrit të dështonte. Por përgjakja në operacionin e dimrit ishte e dyanshme. Edhe forcat partizane në këto operacione dhanë rreth 1000 dëshmorë, po aq të plagosur si dhe një pjesë të sëmure rëndë të ngrirë nga këmbët si dhe që u larguan përkohësisht nga njësitë e tyre. Dhe jo vetëm kaq por bëri që në vend që të zvogëlohej e të shuhej lëvizja nacionalçlirimtare ajo u rrit në numër dhe vijoi përbaljen vendosmërisht deri në çlirim. Vetëm gjatë operacionit të dimrit UNÇSH ju shtuan dhe katër brigade të reja sulmuese: Brigadat IV, V, VI, VII Sulmuese. Këto Brigada luajtën një rol vendimtar në përbalimin e sulmeve dhe thyerjen e operacioneve barbare gjermane në të gjithë fazat e tij. Fakti që as Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH dhe as njësitë luftarake të saj nuk u ndodhën në befasi tregon për nivel të lartë drejtimi dhe zhdërvjelltësi të njësive partizane duke manovruar përmes terreneve malore. Edhe pas operacionit gjerman të dimrit UNÇSH ngeli e vetmja forcë vitale që erdhi duke u konsoliduar deri në çlirim përfundimtar të Shqipërisë dhe të ndjekës së armikut me urdhër të Komandës së Përgjithshme unike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, edhe jashtë kufijve administrativë. Këto gjëjnë pasqyrim edhe në dy vëllimet dokumentare të Dokumenteve të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.





## Ndërron jetë në moshën 79-vjeçare, aktori i njohur i humorit dhe cirkut të Tiranës, “Artisti i Popullit”, Skënder Sallaku

**S**kënder Sallaku lindi në Tiranë më 25 janar 1935 dhe vdiq më 11 shkurt 2014 në Tiranë, në moshën 79-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë. Ai ishte një nga aktorët tanë të humorit, ish-kampion kombëtar në mundjen klasike, autor skeçesh e parodish. Me aktrimin e tij, ai i ka dhuruar brezave të tërë buzëqeshje e humor. Ka mbaruar Institutin e Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi” dhe ka kryer një kualifikim një vjeçar në Kinë, pranë cirkut të Pekinit. Fillimisht, filloi punë si profesionist në Estradën e Kufirit, më pas si klloun akrobatik në cirk, duke dhënë një kontribut të papërsëritshëm në ecurinë e këtij profili sa të vështirë aq edhe të bukur. ka vazhduar paralelisht dhe në film, humor, dramë, etj. Skënder Sallaku kishte një karrierë 60-vjeçare në skenë. Përveç çmimit “Artist i Popullit”, ai ka dhe titullin “Artist i Merituar”, “Mirënjohja e Qytetit”, etj. Ndër rolet e tij në filma, veçojmë “Oreksi i Madh” (1995); “Revolja e Humbur” (1995); “Gjuetia e fundit” (1992); “Cirku në fshat” (1977); “Kur hiqen maskat” (1975); “Estrada në ekran” (1968). I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij!



In memoriam

